


# **ANALIZA E PËRMBAJTJES DHE IMPLEMENTIMIT PRAKTIK TË LIGJIT PËR AGJENCINË TEKNIKE OPERATIVE DHE LIGJIT PËR NDJEKJEN E KOMUNIKIMEVE**

---

Autore

Prof. Dr. Biljana Karovska - Andonovska

**Shkup, shkurt 2021**



### **Për këtë analizë**

Kjo analizë është përgatitur si pjesë e programit të DCAF për reforma në sektorin e zbulimit në Maqedoninë e Veriut.

Pikëpamjet e shprehura janë vetëm të autorit dhe nuk i pasqyrojnë pikëpamjet e institucioneve të referuara apo të përfaqësuar në kuadër të këtij publikimi.

### **Shënim**

Përmbajtja e këtij publikimi mund të citohet vetëm pas pajtimit me shkrim nga DCAF, dhe me njohjen e burimit.

### **Për DCAF**

DCAF - Qendra e Gjenevës për Qeverisje në Sektorin e Sigurisë është një fondacion ndërkombëtar misioni i të cilës është që të ndihmojë komunitetin ndërkombëtar në ndjekjen e reformës të qeverisjes së mirë në sektorin e sigurisë. DCAF harton dhe promovon norma dhe standarde, realizon hulumtime të përshtatura të politikave, identifikon praktika dhe rekomandime të mira për të promovuar qeverisje demokratike në sektorin e sigurisë, dhe ofron mbështetje këshillëdhënëse brenda vendit dhe programe të ndihmës praktike.

© 2021 DCAF - Qendra e Gjenevës për Qeverisje në Sektorin e Sigurisë

## REZYME EKZEKUTIVE

Analiza e Ligjit për Agjencinë Teknike-Operative dhe Ligjit për ndjekjen e komunikimeve e pasqyron gjendjen momentale nga aspekti i zgjidhjeve normative, por edhe nga aspekti i problemeve reale të detektuara në praktikë, një pjesë e tyre si rezultat i dispozitave ligjore jokonsistente dhe të precizuara në masë të pamjaftueshme. Së këtejmi, theks i veçantë vihet mbi dispozitat të cilat nuk janë në funksion të plotë të prioriteteve të reformave, si dhe të segmenteve të cilat nuk korrespondojnë me dokumentet relevante ndërkombëtare dhe me praktikën e gjykatave evropiane.

Në analizë janë ofruar zgjidhje alternative dhe rekomandime konkrete për tejkalimin e dobësive evidente në disa nga dispozitat ekzistuese ligjore. Kjo, veçanërisht ka të bëjë me disa segmente të apostrofuara në tekstin (dispozitat për ndjekjen e komunikimeve pa ndërmjetësimin e ATO-s; dispozitat për meta të dhënat; disa aspekte të caktuara nga ndjekja e komunikimeve në interes të sigurisë dhe mbrojtjes; siguria e të dhënave, si dhe dispozitat për mbikëqyrje dhe kontroll mbi ndjekjen e komunikimeve).

Struktura e dokumentit përbëhet nga pjesa e hyrjes, qasja në reforma, analiza e legjislacionit, mundësitë dhe sfidat, si dhe pikëpamjet përfundimtare.

Në pjesën e hyrjes janë prezantuar mangësitë e konstatuara në sistemin paraprak të ndjekjes së komunikimeve dhe prioritetet e përcaktuara të reformave të përfshira në Raportin e Grupit të Ekspertëve të Lartë për Çështje Sistemore për Sundimin e së Drejtës i udhëhequr nga z. Rajnhart Pribe, mbi bazën e të cilit u krijuan ndërhyrjet e reformave.

Në pjesën që i përkushtohet qasjes në reforma trajtohet procesi i krijimit të zgjidhjeve ligjore dhe zgjedhja e modelit të ri për ndjekjen e komunikimeve, në masë të madhe është transponuar nga legjislacioni i R. së Kroacisë. Kjo pjesë e përmban pasqyrën e të gjitha ligjeve që e përbëjnë paketën e reformave për ndjekjen e komunikimeve ose kanë të bëjnë me reformën gjithëpërfshirëse të sektorit të sigurisë dhe zbulimit.

Pjesa qendrore dhe thelbësore e analizës së kuadrit ligjor, nga aspekti konceptual është ndarë në dy pjesë: analiza e Ligjit për ATO dhe analiza e Ligjit për ndjekjen e komunikimeve, duke e vënë në dukje atë se dispozitat e këtyre ligjeve në segmente të caktuar domosdoshmërisht ndërthuren. Për këto shkaqe, trajtimi i njërit ligj dhe trajtimi i ligjit tjetër është më se i nevojshëm të përfshihen në të dy pjesët.

Analiza e kuadrit ligjor është më shumë e fokusuar mbi Ligjin për ndjekjen e komunikimeve, meqë Ligji për ATO kryesisht i rregullon çështjet lidhur me kompetencat e ATO-s si ndërmjetësuese në procesin e ndjekjes së komunikimeve, udhëheqjen me ATO-n, të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës. Duke e pasur parasysh rolin e ATO-s në konceptin e përgjithshëm, në analizë sugjerohet superstrukturë teknologjike me digjitalizim përkatës të procesit të përgjithshëm përmes së cilit vendoset kalimi teknik midis operatorit dhe organeve të autorizuara për ndjekjen e komunikimeve, me qëllim që të eliminohen efektet e padëshirueshme anësore, më së shpeshti të shkaktuara nga faktori njeri.

Pjesa në të cilën analizohet Ligji për ndjekjen e komunikimeve është ndarë në tri nënseksione me qëllim që të mundësohet pasqyrë më e mirë e tekstit. Dispozitat

e këtij ligji analizohen me radhë sipas asaj se si janë përfshirë të njëjtat në tekstin ligjor. Fillimisht trajtohet kapitulli që ka të bëjë me ndjekjen e komunikimeve, si masë e posaçme hetuese, pastaj ndjekja e komunikimeve në interes të sigurisë dhe mbrojtjes dhe në fund analizohet kapitulli për mbikëqyrjen dhe kontrollin mbi ndjekjen e komunikimeve.

Si problematike apostrofohet pjesa për ndjekjen e komunikimeve pa ndërmjetësimin e ATO-s dhe operatorëve, me instalime dhe pajisje të posaçme teknike, të cilat e mundësojnë një gjë të këtillë. Këto dispozita në të vërtetë nuk korrespondojnë me konceptin në të cilin ATO e ka rolin e ndërmjetësuesit midis operatorëve dhe organeve të autorizuara për ndjekjen e komunikimeve. Prandaj, sugjerohet rishikimi i tyre në drejtim të autorizimit të ATO-s që të manipulojë me regjistrimet për përdorimin e pajisjes (si administrator) dhe të kryejë kontroll mbi regjistrimet. Në drejtimin e njëjtë ATO-s duhet t'i mundësohet rol aktiv edhe sa i përket kontrollit mbi procesin onlajn të ndjekjes së komunikimeve.

Mangësi esenciale janë vërejtur edhe në dispozitat për ndjekjen e komunikimeve në interes të sigurisë dhe mbrojtjes. Me fjalë të tjera, sa u përket dispozitave për meta të dhënat është konstatuar se të njëjtat nuk korrespondojnë me praktikën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe me qëndrimin e Komisionit të Venecias për përdorimin e meta të dhënave. Në lidhje me meta të dhënat janë theksuar edhe dispozita jokonsistente të cilat janë përfshirë në Ligjin për procedurë penale me ç'rast është ofruar zgjidhje alternative për rregullimin e kësaj problematike.

Diskutabile janë edhe një pjesë e masave të reja për ndjekjen e komunikimeve në interes të sigurisë dhe mbrojtjes. Ato duhet të rishikohen meqë nuk përputhen plotësisht me përkufizimin për ndjekjen e komunikimeve në kuptimin e Ligjit për ndjekjen e komunikimeve, ndërsa njëkohësisht bëjnë pjesë në domenin në disa nga autorizimet policore të përcaktuara në Ligjin për polici. Së këtejmi, aplikimi i tyre parandalues duhet të rregullohet në mënyrë më precize meqë kjo nënkupton zbatim të masave invazive vetëm në bazë të indiceve, pa ekzistimin as të bazave të dyshimit.

E fundit në këtë varg është futja joselektive e të gjitha veprave penale kundër forcave të armatosura në kornizën për ndjekjen e komunikimeve e që nuk korrespondon me parimet ndërkombëtare, të cilat e nënkuptojnë aplikimin e teknikave speciale hetuese vetëm sa u përket formave më të rënda të krimit.

Në linjën e prioriteteve të përcaktuara të reformave sugjerohet trajtim më serioz i materies së sigurisë së të dhënave të cilat janë siguruar me ndjekjen e komunikimeve përmes zbatimit të masave konkrete teknike dhe organizative për sigurinë në të gjitha fazat e përpunimit, ruajtjes dhe shkatërrimit të të dhënave.

Në pjesën e mbikëqyrjes, një hap pozitiv është inkorporimi i risive të caktuara, siç është angazhimi i ekspertëve teknikë, procedura e shkurtuar për lëshimin e certifikatave të sigurisë, mbikëqyrja pa paralajmërim etj. Megjithatë, kundrejt kësaj, është vlerësuar se Komisioni ka autorizime të kufizuara të cilat nuk mundësojnë mbikëqyrje cilësore dhe efikase mbi ligjshmërinë e ndjekjes së komunikimeve. Së këtejmi, rekomandohet që Komisioni të posedojë një spektër më të gjerë të veprimeve, por edhe qasje deri te instalimet e ATO-s, si dhe këqyrje në urdhrat e paanonimizuar gjyqësore. Vetëm në këtë mënyrë, Komisioni do të mund të konstatojë nëse disa persona, numri i telefonit ose e-mail adresa janë ndjekur në mënyrë të paligjshme. Përveç kësaj, urgjentisht duhet të rregullohet statusi i Këshillit të Mbikëqyrjes Qytetare i cili tani është i padefinuar dhe prandaj ky trup është jofunksional. Në këtë drejtim, është më se e nevojshme të

rishikohen autorizimet e Këshillit të Mbikëqyrjes Qytetare, të cilat aktualisht janë të kufizuara dhe nuk mundësojnë veprim direkt pas pranimit të parashtrës nga qytetari.

Sa i përket kontrollit përsëri duhet t'i përkushtohet vëmendje ndjekjes së komunikimeve me instalime dhe pajisje të posaçme dhe pa ndërmjetësimin e ATO-s, me ç'rast autorizimet e dhëna për kontroll nga prokurori kompetent publik, Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe gjyqtari i procedurës paraprake, me sa duket në praktikë nuk realizohen për shkak të njohurive të nevojshme teknike për funksionimin e këtyre instalimeve dhe pajisjes, e që nuk është reale të pritet se i posedojnë këto subjekte.

Pjesa që i përkushtohet mundësive dhe sfidave është fokusuar në pasojat nga dobësitë evidente normative dhe në detyrimet e porealizuara ligjore në zbatimin thuaja se dyvjeçar të modelit të ri për ndjekjen e komunikimeve (pa përgatitja teknike dhe personale e Drejtorisë së Doganave dhe Drejtorisë së Policisë Financiare për ndjekjen e pavarur të komunikimeve; detyrimi ligjor pjesërisht i realizuar për zgjedhjen e ekspertëve teknikë në Komisionin Parlamentar për Mbikëqyrje; jofunksionaliteti i Këshillit të Mbikëqyrjes Qytetare). Në mënyrë plotësuese, e gjithë kjo shoqërohet me pretendimet për mosrealizimin e segmentit thelbësor të reformës - ndarja e ndjekjes së komunikimeve si masë MPH, nga ndjekja në interes të sigurisë dhe mbrojtjes, për kinse mundësitë akoma të pranishme teknike (kablo optik) për ta kuptuar përmbajtjen e të gjitha komunikimeve të ndjekura nga ASN e re e cila është vendosur në selinë e ish-DSK-së.

Pikëpamjet përmbyllëse të analizës nga njëra anë paraqesin sublimim të rekomandimeve konkrete për korrigjime normative, dhe nga ana tjetër nevojë për detektimin e problemit në një kontekst më të gjerë. Në këtë kuptim, mes tjerash, rekomandohet ndarje e qartë e autorizimeve të shërbimeve të sigurisë, krijim të konceptit të qartë për tejkalimin e ndikimeve politike mbi shërbimet e sigurisë dhe organet e jurisprudencës, si dhe krijim të zgjidhjeve ligjore të cilat korrespondojnë me kapacitetet e institucioneve.

## **PËRMBAJTJA**

<b>1. HYRJE</b> .....	<b>7</b>
<b>2. QASJA NË REFORMA</b> .....	<b>8</b>
<b>3. ANALIZË E LEGJISLACIONIT PËR NDJEKJEN E KOMUNIKIMEVE</b> .....	<b>10</b>
<b>3.1. Ligji për Agjencinë Teknike-Operative</b> .....	<b>10</b>
<b>3.2. Ligji për ndjekjen e komunikimeve</b> .....	<b>13</b>
3.2.1. Ndjekja e komunikimeve në funksion të hetimeve penale .....	13
3.2.2. Ndjekja e komunikimeve në interes të sigurisë dhe mbrojtjes .....	17
3.2.3. Mbikëqyrja dhe kontrolli mbi ndjekjen e komunikimeve .....	20
<b>4. MUNDËSI DHE SFIDA</b> .....	<b>27</b>
<b>5. PIKËPAMJE DHE REKOMANDIME PËRFUNDIMTARE</b> .....	<b>29</b>
<b>BIBLIOGRAFIA</b> .....	<b>31</b>

## 1. HYRJE

Në këtë punim janë analizuar ligjet të cilat janë pjesë e pakos së reformave me të cilën në vitin 2018, në kuadër të reformës gjithëpërfshirëse të shërbimeve të sigurisë-zbulimit, u reformua edhe sistemi i ndjekjes së komunikimeve. Në këtë drejtim, në fokus të analizës është Ligji për ndjekjen e komunikimeve dhe Ligji për Agjencinë Teknike Operative si ligje kryesore në këtë fushë. Megjithatë, për shkak të lidhshmërisë së ngushtë të problematikës, në këtë tekst u trajtuan edhe dispozita të caktuara të paevitueshme nga ligje të tjera, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë kanë të bëjnë me këtë problematikë, si dhe u bë një vështrim përkatës komparativ mbi disa segmente të Ligjit për sistemin e sigurisë-zbulimit të Republikës së Kroacisë të cilët u përdorën si model për krijimin e sistemit të reformuar për ndjekjen e komunikimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Qëllimi i analizës është detektimi i mangësive të dispozitave të caktuara ligjore dhe dobësive gjatë implementimit të tyre. Qëllimi i fundit i analizës është të vihet në dukje nëse janë përmbushur prioritetet e përcaktuara të reformës përmes prizmit të zbatimit thuaja se dyvjeçar të konceptit të ri të ndjekjes së komunikimeve.

Reformimi i sistemit të ndjekjes së komunikimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut u imponua si nevojë e shkaktuar nga përgjimi i paligjshëm dhe masiv për të cilin publiku u informua gjatë vitit 2015. Si rezultat i këtyre ngjarjeve, Grupi i Ekspertëve të Lartë për Çështje Sistemore për Sundimin e së Drejtës, i formuar nga Komisioni Evropian dhe i udhëhequr nga Rajnhard Pribe, hartoi Raport (“Raporti i Pribes”) në të cilin u përcaktua gjendja faktike dhe rekomandoi zgjidhje përkatëse në fushat në të cilat ishin detektuar mangësi. Në dokumentin me titullin “Prioritete urgjente reformuese”,<sup>1</sup> u konstatuan mangësi sistemore, përqendrim të fuqisë dhe keqpërdorim të mekanizmit për mbikëqyrje nga ish-Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim (DSK), si dhe ekskluzivitet në ndjekjen e komunikimeve nga DSK. Raporti i dytë i Pribes i vitit 2017 përmban vlerësim për rrjedhën e deriatëhershme të reformave dhe rekomandime për hapat e mëtutjeshëm të procesit reformues.<sup>2</sup>

Sa i përket mbikëqyrjes parlamentare mbi organet e autorizuara për ndjekjen e komunikimeve, ekspertët konstatuan se teoretikisht është vendosur në formë të komisioneve parlamentare të cilat megjithatë nuk bëjnë mbikëqyrje inspektuese në DSK, madje nuk grumbullojnë as të dhëna statistikore për ndjekjen e komunikimeve. Si shkaqe për mbikëqyrjen joefikase, mes tjerash, janë theksuar mangësi të njohurive teknike dhe procedura e gjatë për lëshimin e certifikatave të sigurisë për anëtarët e komisioneve, si dhe bojkotimi i vazhdueshëm i komisioneve për shkak të bojkotimit të punës së Parlamentit nga opozita e atëhershme.

<sup>1</sup> I aksesshën në: [http://ec.europa.eu/enlargement/news\\_corner/news/news-files/20150619\\_urgent\\_reform\\_priorities.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/news_corner/news/news-files/20150619_urgent_reform_priorities.pdf)

<sup>2</sup> I aksesshëm në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14\\_seg\\_report\\_on\\_systemic\\_rol\\_issues\\_for\\_publication.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf)

## 2. QASJA NË REFORMA

Në bazë të analizës, Grupi i Ekspertëve i udhëhequr nga R. Pribe, në raportin e parë, mes tjerash, rekomandoi t'i hiqet roli ndërmjetësues DSK-së dhe mundësia për qasje të drejtpërdrejtë në pajisjen teknike e cila e mundëson pasqyrimin e sinjalit të komunikimeve, zhvendosjen e instalimeve për ndërmjetësim në hapësirat e operatorëve të telekomunikacioneve të cilët do t'i aktivizojnë dhe përcjellin sinjalet deri te organet e autorizuara për ndjekjen e komunikimeve vetëm pas pranimit të urdhrat relevant gjyqësor. U rekomandua edhe përforsimi i sigurisë së të dhënave, ruajtja e tyre në një regjim të veçantë, seleksionimi dhe punësimi në shërbimet në bazë të kriterëve të rrepta, meritave dhe integritetit, trajnimit të tyre të rregullt, sigurimit të kuadrit të trajnuar mirë, i cili do ta kontrollojë punën e shërbimeve të zbulimit, përfshirjes së ekspertëve teknikë si mbështetje për komisionet parlamentare për mbikëqyrje mbi shërbimet e sigurisë dhe mbi zbatimin e masave për ndjekjen e komunikimeve.

Në bazë të dobësive të konstatuara dhe rekomandimeve të propozuara, u krijua korniza ligjore për ndjekjen e komunikimeve nga e cila pritej ta sigurojë bazën e legjislacionit për një sistem të balancuar i cili do t'i pamundësojë përgjimet e paligjshme. Procesi i krijimit të strukturës organizative bazike të sistemit për ndjekjen e komunikimeve u zhvillua në mungesë të një debati gjithëpërfshirës të bazuar në pikëpamje të qëndrueshme shkencore dhe profesionale. Kundrejt rekomandimeve dhe pritshmërive për transparencë më të madhe, modeli i ndjekjes së komunikimeve u përzgjedh pa debat paraprak publik. Modeli përfshiu një subjekt të veçantë – Agjencinë Teknike Operative (ATO), si ndërmjetësuese midis organeve të autorizuara për ndjekjen e komunikimeve dhe operatorëve, e cila duhet vetëm ta përcjellë sinjalin, pa mundësi për ta kuptuar përmbajtjen e komunikimeve të ndjekura.

Modeli i ri për ndjekjen e komunikimeve nuk korrespondon me rekomandimet e Grupit të Ekspertëve të udhëhequr nga R. Pribe, posaçërisht me rekomandimet të cilat sugjeronin zhvendosjen e instalimeve për ndërmjetësim në hapësirat e operatorëve të telekomunikacioneve.

Pas përzgjedhjes jotransparente të modelit për ndjekjen e komunikimeve, pasuan disa debate dhe takime publike, në mesin e të cilave edhe me përfaqësuesit e sektorit joqeveritar, në të cilat një pjesë e vërejtjeve u pranuan, por për një pjesë tjetër propozuesi i këtyre ligjeve nuk manifestoi gatishmëri për t'i pranuar edhe pse të njëjtat ishin në drejtim të përmirësimit të zgjidhjeve të propozuara ligjore.

Paketa e reformave në fushën e ndjekjes së komunikimeve në të vërtetë përmban dy ligje të reja, Ligjin për ndjekjen e komunikimeve<sup>3</sup> dhe Ligjin për Agjencinë Teknike Operative.<sup>4</sup> Me qëllim të harmonizimit me disa dispozita të këtyre ligjeve, në periudhën e njëjtë kohore u miratuan ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për komunikime elektronike<sup>5</sup> dhe Ligjit për procedurë penale<sup>6</sup>, si dhe plotësimi i Ligjit për informacione të klasifikuara<sup>7</sup>. Pak më vonë, u miratua edhe Ligji për Agjencinë e Sigurisë Nacionale<sup>8</sup> dhe Ligji për koordinimin e bashkësisë të sigurisë dhe

<sup>3</sup> Ligji për ndjekjen e komunikimeve "Gazeta Zyrtare" nr. 71/18, 108/19

<sup>4</sup> Ligji për Agjencinë Teknike Operative "Gazeta Zyrtare" nr. 71/18

<sup>5</sup> Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për komunikime elektronike "Gazeta Zyrtare" nr. 11/18, 98/19

<sup>6</sup> Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurë penale "Gazeta Zyrtare" nr. 198/18


<sup>7</sup> Ligji për plotësimin e Ligjit për informacione të klasifikuara "Gazeta Zyrtare" nr. 21/18

<sup>8</sup> Ligji për Agjencinë e Sigurisë Nacionale "Gazeta Zyrtare" nr. 108/19



zbulimit.<sup>9</sup> Kuadri i reformës legjislative duhet të rrumbullakohet me miratimin e ligjit të ri për Agjencinë e Zbulimit.<sup>10</sup>

Lihet përshtypje se u krijuan zgjidhje parciale ligjore, pa vizion të qartë për sistemin e përgjithshëm të sigurisë dhe zbulimit. Një gjë të këtillë e konfirmon edhe fakti se për një kohë të shkurtër, spektri i parë e ligjeve të miratuara në vitin 2018, iu nënshtruan ndryshimeve ose plotësimeve që të harmonizohen me ligjet të reja ndërkohë të miratuara, përkatësisht në vitin 2019.



<sup>9</sup> Ligji për bashkërenditjen e komunitetit të sigurisë-zbulimit "Gazeta Zyrtare" nr. 108/19

<sup>10</sup> Ligji për Agjencinë e Zbulimit "Gazeta Zyrtare" nr. 21/2021

### 3. ANALIZË E LEGJISLACIONIT PËR NDJEKJEN E KOMUNIKIMEVE

Në analizën e legjislacionit e cila është prezantuar në vazhdim, janë përfshirë dispozitat e Ligjit për Agjencinë Teknike Operative (LATO) dhe Ligjit për ndjekjen e komunikimeve (LNK). Së këtejmi, për shkak të lidhshmërisë së ngushtë të këtyre dy ligjeve dhe të një sërë akteve të tjera ligjore, siç u theksua edhe në hyrje, në pjesën që ka të bëjë me LATO-n u trajtuan disa dispozita të LNK-së të cilat drejtpërdrejt kanë të bëjnë me ATO-n, ndërsa pjesa që ka të bëjë me LNK-në në mënyrë të paevitueshme i trajton edhe dispozitat e ndërlidhura të akteve të tjera ligjore.

#### 3.1. Ligji për Agjencinë Teknike-Operative

Logjika e njërit nga rekomandimet e përfshira në “Raportin e Pribes” konsiston me atë se instalimet e ndërmjetësimit duhet të zhvendosen në hapësirat e operatorëve të telekomunikacioneve të cilat do t'i aktivizojnë dhe përcjellin sinjalet deri tek organet për ndjekjen e komunikimeve vetëm pas pranimit të urdhrat gjyqësor. Kundrejt kësaj, në përputhje me modelin e përzgjedhur, me një ligj të veçantë, i miratuar njëkohësisht me Ligjin e ri për ndjekjen e komunikimeve në vitin 2018, u formua autoriteti i pavarur dhe i mëvetësishëm shtetëror i cili siguron lidhje teknike midis operatorëve dhe organeve të autorizuar (neni 2 i LATO-s). Modeli është marrë nga legjislacioni kroat dhe në masë të madhe janë pasqyruar dispozitat nga Ligji për sistemin e sigurisë dhe zbulimit të Republikës së Kroacisë.<sup>11</sup> Përparësinë e këtij modeli, MPB si propozues e justifikoi, mes tjerash, me shmangien e përqendrimit të fuqisë në një organ dhe mundësinë e kontrollit të dyfishtë. Edhe pse modeli në bazë është identik me modelin kroat, megjithatë mund të vërehen edhe disa dallime, të cilat i kemi apostrofuat në vazhdim të kësaj analize.

Që në fillim të procesit reformues, modeli në të cilin ATO-s iu dha roli i ndërmjetësuesit dhe koordinatorit të ndjekjes së komunikimeve, imponoi disa çështje të caktuara, mes tjerash, edhe për shkak të faktit se ATO e ndërmori pajisjen e njëjtë, e cila për këtë dedikim përdorej nga DSK. Edhe pse Ligji për ATO-n në nenin 2 paragrafin 2 ka dispozitë në lidhje me atë se ATO nuk posedon mundësi teknike për qasje në përmbajtjen e komunikimit të ndjekur, megjithatë, kundrejt kësaj, LNK në nenin 35 paragrafin 1 përcaktoi se me qëllim të themelimit dhe vendosjes papengesa të ATO-s, Qeveria siguron se instalimet teknike LEIMD<sup>12</sup> dhe LEMF<sup>13</sup> për ndjekjen e komunikimeve, si dhe dokumentacionit teknik, do të zhvendosen nga DSK në ATO.

Në përputhje me nenin 35 paragrafin 3 dhe 4 të Ligjit për ATO u përcaktua mundësia nga DSK në ATO të transferohen më së shumti shtatë persona të cilët kanë përvojë për të manipuluar me instalimet teknike për qëllimet e ndjekjes së komunikimeve. Integriteti i personave të transferuar nga ish DSK në ATO ishte jashtëzakonisht i rëndësishëm për shkak të rikthimit të besimit të humbur të

<sup>11</sup> Zakon o sigurnosno-obavještajnom sustavu Republike Hrvatske, në dispozicion në: <https://www.uvns.hr/UserDocsImages/dokumenti/nacionalna-sigurnost/ZAKON-O-SIGURNOSNO-OBAVJESTAJNOM-SUSTAVU-RH-NN-79-2006.pdf>

<sup>12</sup> Pajisja ndërmjetësuese teknike dhe mbështetja përkatëse softuerike që e mundëson aktivizimin e masës ndjekje të komunikimeve.

<sup>13</sup> Pajisje për ndjekjen e komunikimeve e cila përbëhet nga mjete nga të cilat përcillet përmbajtja e ndjekjes së komunikimeve dhe informacioneve që kanë të bëjnë me komunikimin e ndjekur.

publikut të gjerë në lidhje me punën e shërbimeve të sigurisë. Edhe pse procesi i ekipimit të ATO-s nuk ishte mjaftueshëm transparent, ndërsa publiku nuk ishte i njoftuar në mënyrë përkatëse me kriteret në bazë të të cilave u transferuan punonjësit nga DSK në ATO, megjithatë ATO në mënyrë efikase dhe efektive u formua si shërbim i veçantë. Disa rezerva të caktuara të cilat u manifestuan në drejtim të asaj se shërbimit të sapoformuar dhe pamjaftueshëm të ekipuar i mundësohet qasje relativisht e lehtë në të dhënat sensitive ishin pasojë e besimit paraprakisht të humbur ndaj shërbimeve të cilat janë përfshirë në procesin e ndjekjes së komunikimeve dhe për faktin se shteti disa herë u ballafaqua me afëra të mëdha për përgjime të paligjshme.

Ligji për ATO-n kryesisht i rregullon çështjet që kanë të bëjnë me kompetencat e ATO-s si ndërmjetësuese në procesin e ndjekjes së komunikimeve, udhëheqjen me ATO-n si dhe të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës.

Nga distanca e tanishme kohore edhe pas dy vjetësh jo të plota nga fillimi i zbatimit të LNK-së dhe LATO-s, e që megjithatë është periudhë relativisht e shkurtër kohore, mund të supozohet se modeli i përzgjedhur për ndjekje të komunikimeve me ndërmjetësimin e ATO-s me sa duket e rëndon procedurën me një varg veprimesh që duhet të ndërmerren para fillimit të realizimit të urdhrimit gjyqësor për ndjekjen e komunikimeve (instalimi i numrit identifikues si mekanizëm për anonimizim, anonimizimin e urdhrimit gjyqësor me qëllim të përcjelljes deri te ATO, dërgimin e urdhrimit të anonimizuar deri te ATO, aktivizimin e sistemit në ATO etj.). Nga ana tjetër, efekti pozitiv i modelit të ri përbëhet në ekzistimin të edhe një shtrese të mbikëqyrjes, përkatësisht mundësi për mbikëqyrje më cilësore mbi ndjekjen e komunikimeve në kuptimin e ekzistimit të më shumë pikave nga të cilat mund të merren të dhëna të cilat pastaj mund të krahasohen. Procesin e përgjithshëm përmes të cilit vendoset kalimi teknik midis operatorit dhe organeve të autorizuara duhet të përmirësohet në aspektin teknologjik përmes digjitalizimit të procesit, me ç'rast do të eliminohen efektet anësore dhe dukuritë e padëshiruara, më së shpeshti të shkaktuara nga faktori njeri.

### **PROCESI I NDJEKJES SË KOMUNIKIMEVE**

ATO aktivizon dhe krijon kushte teknike për ndjekjen e komunikimeve për hetime penale dhe për mbrojtjen e interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit (neni 3 paragrafi 1 nga LATO). Procesin e ndjekjes së komunikimeve, i cili rregullohet me dispozitat e LNK-së, zhvillohet në atë mënyrë që pas lëshimit të urdhrimit gjyqësor për ndjekjen e komunikimeve, ATO-s i dërgohet një kopje e anonimizuar e atij urdhri. Në përputhje me nenin 64 të LNK-së, personi i autorizuar në ATO e ka për detyrë ta aktivizojë menjëherë dhe komunikimin ta bëjë të aksesshëm për të cilin është lëshuar urdhri, si dhe ta ndërpresë ndjekjen e komunikimeve në rastin kur ka skaduar koha e përcaktuar në urdhrin ose është lëshuar urdhër për ndërprerjen e masës. Në këtë proces, ATO bën edhe mbikëqyrje profesionale mbi punën e operatorëve.

### **KUSHTET PËR ZGJEDHJEN E DREJTORIT TË ATO-S**

Drejtorin e ATO-s e zgjedh dhe e shkarkon Kuvendi me shumicë prej dy të tretat e votave për mandat prej pesë vitesh pa të drejtë për rizgjedhje. Këto janë zgjidhje korrekte ligjore, veçanërisht shumica e dy të tretave e cila në fakt e konfirmon legjitimitetin e drejtorit të zgjedhur dhe konsensusin e arritur midis partive politike në Parlament sa i përket personit konkret. Është për t'u përsëritur edhe ajo se njëra nga bazat për shkarkimin e drejtorit të ATO-s, në përputhje me nenin 9 paragrafin 2 alinenë 2 nga LATO, është përcaktuar parandalimi i

kontrollit dhe mbikëqyrjes së organeve kompetente nga ana e drejtorit të ATO-s. Me këtë dërgohet sinjal për rëndësinë të cilën ligjvënësi ia jep mbikëqyrjes dhe kontrollit si segmente jashtëzakonisht të rëndësishme të sistemit të ndjekjes së komunikimeve.

Megjithatë, është e paqartë pse neni 5 i Ligjit për ATO e ka parashikuar vetëm shtetësinë, shkallën e arsimit dhe përvojën përkatëse të punës si kushte për zgjedhjen e drejtorit. Si kusht nuk është përcaktuar mosekzistimi i konfliktit të interesave dhe mosekzistimi i rrezikut të sigurisë nga zgjedhja e personit konkret për drejtor (siç është përcaktuar për drejtorin e ASN-së, por edhe për personat e autorizuar zyrtarë edhe në ATO edhe në ASN).

### REKOMANDIM

Kushtet e parashikuara në nenin 10 të Ligjit për ASN mund të merren edhe sa i përket zgjedhjes së drejtorit të ATO-s.

### RAPORT PËR PUNËN E ATO-S

Në përputhje me nenin 7 të Ligjit për ATO, drejtori e paraqet për shqyrtim Raportin vjetor për punën e ATO-s për vitin paraprak kalendarik në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili mes tjerash duhet ta përmbajë numrin e komunikimeve të aktivizuara për çdo organ të autorizuar veç e veç. Në këtë numër nuk përfshihet numri i komunikimeve të aktivizuara për sigurinë dhe mbrojtjen, e që si zgjidhje ligjore mund të justifikohet vetëm nga aspekti i asaj se për publikun e gjerë mjafton të informohet vetëm për numrin e përgjithshëm të masave të aktivizuara. Megjithatë, komisionet parlamentare të cilat kryejnë mbikëqyrje në këtë sektor, duhet të posedojnë informacione që janë tregues për gjendjen sa i përket sigurisë nacionale dhe sa i përket se si dhe në ç'masë institucionet kompetente ballafaqohen me këtë. Komisionet e Kuvendit dhe Kuvendi në bazë të treguesve relevantë duhet ta rishikojnë, kontrollojnë dhe aprovonë buxhetin e shërbimeve të sigurisë. Së këtejmi, për nevojat e mbikëqyrjes numri i komunikimeve të aktivizuara në interes të sigurisë dhe mbrojtjes, si informacion duhet t'u dërgohet komisioneve parlamentare.

### REKOMANDIM

Në këtë drejtim, dispozitat lidhur me përmbajtjen e Raportit vjetor për punën e ATO-s duhet të modifikohen, ndërsa disa nga alternativat e mundshme janë si vijon:

- Në nenin 7 paragrafin 2 alinenë 2, të shlyhet fjalia e dytë sipas së cilës në numrin e komunikimeve të aktivizuara për çdo organ të autorizuar veç e veç “nuk theksohet numri i komunikimeve të aktivizuara për sigurinë dhe mbrojtjen”;
- Neni 7 paragrafi 2 të plotësohet me aline të re sipas së cilës, në raport të veçantë për nevojat e mbikëqyrjes ose në formë të ndonjë lloji tjetër të korrespondencës me shkrim, në numrin e përgjithshëm të komunikimeve të aktivizuara të theksohet edhe numri i komunikimeve të aktivizuara në interes të sigurisë dhe mbrojtjes.

Në përputhje me Raportin vjetor për vitin 2018,<sup>14</sup> ATO ka ndërmjetësuar në aktivizimin e masave për gjithsej 153 komunikime, nga të cilat 5 komunikime për nevojat e Departamentit për luftimin e krimit të organizuar dhe serioz në BSP pranë MPB-së, ndërsa 8 komunikime për nevojat e Prokurorisë Speciale Publike. Nuk ka informacione për 142 komunikimet e tjera, ndërsa nuk është reale të supozohet se ato janë në kuadër të komunikimeve për të cilat numri nuk duhet të theksohet në këtë raport.

Për shkak të situatës aktuale dhe implikimeve nga gjendja e shpallur e jashtëzakonshme, Raporti për punën e ATO-s për vitin 2019 u shqyrtua në mbledhjen e Qeverisë më datë 22.04.2020,<sup>15</sup> megjithatë i njëjti akoma nuk është publikuar në ueb-faqen e ATO-s. Në përputhje me procesverbalin nga mbledhja e Qeverisë, mes tjerash, Raporti përmban informatë se në vitin 2019 nga ATO janë ndjekur 269 komunikime për nevojat e Byrosë për Siguri Publike pranë MPB. Megjithatë, gjatë numërimit teknik në sistemin e ndjekjes dhe pas këqyrjes së bërë në urdhrat e dërguar gjyqësorë, rinumërimi i targetëve aktivë, numrave telefonikë dhe e-mail adresave, është konstatuar se *numrat në Raportin e ATO-s nuk korrespondojnë me numrat e evidencës së MPB-së*. Nga ATO u pranuan përgjigje se dallimi në pjesën e komunikimeve të përcjella teknike është rezultat i asaj se *metodologjia e ATO-s është e ndryshme nga metodologjia e MPB-së*.

## REKOMANDIM

ATO dhe MPB, si dhe të gjitha subjektet e tjera të përfshira në procesin e përcjelljes dhe ndjekjes së komunikimeve, si dhe në procesin e mbikëqyrjes dhe kontrollit, duhet të specifikojnë metodologji unike për numërimin dhe këqyrjen e të gjitha të dhënave relevante që kanë të bëjnë me këtë proces.

### MBIKËQYRJA PROFESIONALE MBI OPERATORËT

ATO është e autorizuar të bëjë mbikëqyrje profesionale mbi operatorët e cila përbëhet nga mbikëqyrja mbi përdorimin e pajisjes teknike dhe linjat elektronike të komunikimeve të cilat shërbejnë për lidhjen e ATO-s me operatorët (neni 32 nga LATO). Në këtë drejtim, në nëntor të vitit 2018, drejtori i ATO-s formoi Komision për mbikëqyrje profesionale, i cili konform Raportit për vitin 2018 ka realizuar disa takime me operatorët në të cilat është prezantuar Propozim-Udhëzuesi për mënyrën e veprimit të operatorëve. Në vitin 2018, për shkak të periudhës së shkurtër nga themelimi i ATO-s, nuk është kryer mbikëqyrje mbi operatorët. Për vitin 2019, siç është theksuar më lart, Raporti për punën e ATO-s akoma nuk është plotësisht i aksesshëm.

## 3.2. Ligji për ndjekjen e komunikimeve

Ligji për ndjekjen e komunikimeve si *lex specialis* sa i përket zbatimit të masave për ndjekjen e komunikimeve e rregullon procedurën e ndjekjes në funksion të hetimeve penale; kushtet dhe procedurën e ndjekjes në interes të sigurisë dhe mbrojtjes; çështjet e mbikëqyrjes dhe kontrollit në këtë fushë; si dhe detyrimet e ATO-s dhe operatorëve në procesin e ndjekjes së komunikimeve.

Sipas kësaj radhitjeje është bërë edhe analiza e dispozitave të LNK-së me ç'rast fillimisht theksi është vënë mbi dispozitat të cilat nga aspekti nomoteknik

<sup>14</sup> <https://ota.mk/adocs/scan-izvestaj-ota-2018.pdf>

<sup>15</sup> Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, mbledhja e 45-të e mbajtur më datë 22.04.2020, e aksesshme në: <https://vlada.mk/vladini-sednici>

përmbajnë formulime pamjaftueshëm të qarta dhe precize, si dhe dispozita të cilat duhet të rishikohen seriozisht dhe të riformulohen në mënyrë përkatëse.

### 3.2.1. Ndjekja e komunikimeve në funksion të hetimeve penale

Organe të autorizuara për ndjekjen e komunikimeve për shkak të hetimeve penale janë prokurori publik dhe policia gjyqësore (nëpunës policorë nga MPB dhe pjesëtarë të policisë financiare, persona të autorizuar të Drejtorisë së Doganave dhe persona të autorizuar zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes të cilët punojnë në zbulimin dhe kallëzimin e veprave penale). Urdhër për ndjekje të komunikimeve nxjerr gjyqtari kompetent i procedurës paraprake, në bazë të kërkesës së prokurorit kompetent publik.

Kapitulli nga LNK i cili ka të bëjë me ndjekjen e komunikimeve për hetime penale është titulluar: “Procedura për zbatimin e masës së posaçme hetuese.” Titulli i formuluar në këtë mënyrë, mund të aludojë për të gjitha (gjithsej 12) masat e posaçme hetuese (masa MPH) të përcaktuara në Ligjin për procedurë penale (LPP), në vend të masës MPH nga neni 252 paragrafi 1 pika 1 nga LPP për të cilën në të vërtetë ka të bëjë ky kapitull. Nuk mjafton ajo që në nenin 4 paragrafin 1 pikën 4 të LNK-së, nocioni “masa e posaçme hetuese” është sqaruar si “ndjekje dhe regjistrim të komunikimeve telefonike dhe të komunikimeve tjera elektronike”, meqë në përputhje me LPP-në masë e posaçme hetuese janë të gjitha masat e nenit 252 paragrafit 1. Për këto shkaqe, titulli i kapitullit do të duhej të riformulohet si vijon: “Procedurë për zbatimin e masës së posaçme hetuese ndjekje dhe regjistrim të komunikimeve telefonike dhe të komunikimeve të tjera elektronike.”

### PROCEDURA NË RASTE URGJENTE

Me nenin 10 të LNK-së urdhri i deritanishëm verbal për ndjekjen e komunikimeve është zëvendësuar me urdhër të përkohshëm me shkrim i cili lëshohet në raste urgjente, si në funksion të hetimeve penale, ashtu edhe në interes të sigurisë dhe mbrojtjes. Kushtet e lëshimit të urdhrit të përkohshëm me shkrim janë përfshirë në formulimin “kur ekziston dyshim i bazuar se zvarritja mund të ndikojë negativisht mbi zbatimin e procedurës” (neni 10), përkatësisht “kur ekziston rrezik nga prolongimi” (neni 30).

### REKOMANDIM

- Për shkak të implikimeve të mundshme nga lëshimi i urdhrit të përkohshëm me shkrim, nevojitet në mënyrë më precize të specifikohen kushtet kur ky urdhër mund të lëshohet, me ç’rast mund të kthehen kushtet të cilët ishin të përfshirë në tekstin bazik të LNK-së nga viti 2006 (më vonë në vitin 2012 u ndryshuan në formulimin e ngjashëm me formulimin aktual) të cilët për lëshimin e urdhrit të atëhershëm verbal parashikonin ekzistim të rrezikut për shkaktimin e vdekjes ose lëndimit të rëndë trupor, arratisjes së personit i cili është kryerës i veprës penale për të cilën është përcaktuar dënim me burgim të përjetshëm ose dëm material me përmasa të mëdha.

### RUAJTJA DHE SHKATËRRIMI I TË DHËNAVE TË GRUMBULLUARA PËRMES NDJEKJES SË KOMUNIKIMEVE

Në përputhje me nenin 16 të LNK-së, pas miratimit të vendimit nga prokurori publik të dhënat nga ndjekja e komunikimeve i dërgohen gjykatës dhe ruhen në afate të përcaktuara varësisht nga ajo nëse është miratuar aktgjykim lirues, aktgjykim

refuzues ose aktgjykim dënues, ndërsa pas skadimit të afateve të dhënat shkatërrohen dhe për këtë përpilohet raport.

Në këto dispozita ligjvënësi duhet t'i përkushtojë vëmendje sigurisë së të dhënave të cilat janë siguruar nga ndjekja e komunikimeve dhe në drejtim të rekomandimeve të "Raportit të Pribes" për fuqizimin e sigurisë së të dhënave, me qëllim të shmangies së çfarëdo lloj rreziku nga përdorimi i tyre i pakontrolluar ose joligjor.

## REKOMANDIM

- Duhet të përcaktohen masa konkrete teknike dhe organizative për sigurinë gjatë përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave nga komunikimet e ndjekura në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale (LMDhP)<sup>16</sup> dhe Direktivën 2016/680 për mbrojtjen e të dhënave personale në hetimet penale.<sup>17</sup>
- Duhet të parashikohet shlyerja e kategorive të posaçme të të dhënave personale, si dhe të deklarimeve që kanë të bëjnë me këtë kategori të të dhënave të siguruar nga ndjekja e komunikimeve.
- Duhet të parashikohet përgjegjësi në rast të mosrespektimit të afateve ligjore për shkatërrimin e të dhënave të grumbulluara përmes ndjekjes së komunikimeve.

### NDJEKJA E KOMUNIKIMEVE ME INSTALIME DHE PAJISJE TË POSAÇME TEKNIKE

Në përputhje me nenin 17 të LNK-së, komunikimet mund të ndiqen me ndihmën e instalimeve dhe pajisjes së posaçme teknike të cilat mundësojnë ndjekje të komunikimeve pa ndërmjetësimin e ATO-s dhe operatorëve. Këto instalime dhe pajisje ruhen në Prokurorinë Themelore Publike për ndjekjen e krimit dhe korrupsionit të organizuar, ndërsa në bazë të urdhrin të lëshuar gjyqësor, personi i autorizuar nga policia gjyqësore i merr instalimet dhe pajisjen teknike, e zbaton ndjekjen e komunikimeve dhe pastaj i kthen instalimet dhe pajisjen. Me LNK nuk është përcaktuar në cilat raste dhe në cilat kushte komunikimet do të ndiqen pa ndërmjetësimin e ATO-s dhe operatorëve. Është e hapur edhe çështja që ka të bëjë me atë se nëse dhe në ç'mënyrë do të bëhet mbikëqyrja mbi ndjekjen e këtillë, meqë kontrolli për këtë lloj të ndjekjes së komunikimeve është rregulluar në mënyrë të veçantë në nenin 60 të LNK-së. Në interes të sigurisë dhe mbrojtjes, po ashtu, është parashikuar ndjekja e komunikimeve me instalime dhe pajisje të posaçme dhe pa ndërmjetësimin e ATO-s dhe operatorëve "në procedurë dhe kushte të përcaktuara me ligj" (neni 34 i LNK-së).

Ligji për Agjencinë e Sigurisë Nacionale (ASN) në nenin 26 këtë çështje e rregullon thuaja se në mënyrë identike si në nenin 17 të LNK-së me atë që përmban dy kufizime të rëndësishme të cilat nuk i përmban neni 17 nga LNK. Me fjalë të tjera, kufizimet kanë të bëjnë me atë se ndjekja pa ndërmjetësimin e ATO-s do të zbatohet *vetëm kur teknikisht ndjekja dhe regjistrimi i komunikimit është i pamundur pa përdorimin e instalimeve dhe pajisjes së posaçme*; si dhe me atë se *personat e autorizuar zyrtarë të ASN-së nuk guxojnë të kenë mundësi teknike ose çfarëdo lloj mundësie tjetër për ndryshimin ose shlyerjen e të dhënave nga instalimet dhe pajisjet e posaçme teknike.*

<sup>16</sup> Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, "Gazeta Zyrtare" nr. 42/20

<sup>17</sup> Directive (EU) 2016/680 of The European Parliament and of The Council of 27 April 2016, on the protection of natural persons with regard to the processing of personal data by competent authorities for the purposes of the prevention, investigation, detection or prosecution of criminal offences or the execution of criminal penalties, and on the free movement of such data



Me nenin 17, paragrafin 7 nga LNK përcaktohet mundësia, por jo edhe detyrimi **për prokurorin kompetent publik në çdo kohë të kërkojë nga personi i autorizuar nga policia gjyqësore të dëgjojë apo ridëgjojë bisedë që është objekt i interesit dhe të bëjë këqyrje në regjistrimet për përdorimin e instalimeve dhe pajisjes. Nga aspekti i kontrollit të procesit, kjo është një zgjidhje korrekte ligjore, por njëkohësisht edhe shumë e mundshme që prokurori publik, megjithatë, nuk ka njohuri teknike për instalimet dhe pajisjen e posaçme, përdorimi i të cilave është rregulluar në këtë pjesë të LNK-së.** Së këtejmi, prokurori publik në praktikë, mesa duket, nuk mund të bëjë këqyrje përkatëse profesionale në regjistrimet nga përdorimi i instalimeve dhe pajisjeve së posaçme, veçanërisht nëse policia gjyqësore mund të manipulojë me regjistrimet për përdorimin e pajisjes. Për më tepër, përjashtimi i ATO-s nga procesi i ndjekjes së komunikimeve në kushte kur nga prokurorët publikë nuk mund të pritët se e zotërojnë funksionimin e teknologjive komplekse dhe të sofistikuara, lë mundësi serioze për kamuflime eventuale nga ana e policisë gjyqësore dhe pamundësimin e kontrollit ex-post. Situata është e ngjashme edhe me ndjekjen online të komunikimeve, ku ATO në mënyrë të padrejtë është përjashtuar nga sistemi i kontrollit. Duke e pasur parasysh atë se thuaia se të gjitha komunikimet elektronike synojnë drejt platformës onlajn, ky mund të jetë një problem serioz dhe pas një kohe të caktuar ta vë në pikëpyetje ekzistimin e ATO-s.

Me dispozitat e përcaktuara në nenin 60 të LNK-së është specifikuar se kontroll mbi mënyrën e përdorimit të instalimeve dhe pajisjeve të posaçme teknike kryen Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe gjyqtari i procedurës paraprake i cili e lëshon urdhrin për ndjekje. Edhe pse me këtë zgjidhje ligjore në shikim të parë përforcohet sistemi i kontrollit, megjithatë, është diskutabil efikasiteti i tij. Është diskutabile se sa në të vërtetë Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka kohë të futet dhe t'i përkushtohet këtij lloji të kontrollit për çdo rast individual. Gjithashtu, edhe në këtë rast është shumë e besueshme se Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk ka njohuri teknike për instalimet dhe pajisjet e posaçme për çka LNK e ka parashikuar mundësinë e angazhimit të ekspertëve teknikë.

## REKOMANDIM

- Meqë ndjekja e komunikimeve me instalime dhe pajisje të posaçme teknike reteron nga sistemi në të cilin ATO e ka rolin e ndërmjetësuesit midis organeve të autorizuar dhe operatorëve, duhet të precizohen të gjitha aspektet relevante të procesit të ndjekjes pa ndërmjetësimin e ATO-s dhe operatorëve, si dhe përcaktimin e mekanizmave për mbikëqyrje kur ndjekja zhvillohet në këtë mënyrë.
- Njëra nga zgjidhjet e mundshme është autorizimi i ATO-s që të manipulojë me regjistrimet për përdorimin e pajisjes (si administrator) dhe të kryej kontroll mbi regjistrimet, në mënyrë të pavarur dhe me kërkesë të prokurorit publik. Me këtë do të arrihet kontroll i shumëfishtë, ndërsa policia gjyqësore do të mund ta përdorë vetëm instalimin, por jo edhe të manipulojë me regjistrimet me çka padyshim se do të zvogëlohet dyshimi nga rreziku për keqpërdorime eventuale. Në këtë drejtim, ATO duhet të ketë rol aktiv edhe në kontrollin mbi procesin e ndjekjes onlajn të komunikimeve.
- Dispozitat që kanë të bëjnë me ndjekjen e komunikimeve në





interes të sigurisë dhe mbrojtjes pa ndërmjetësimin e ATO-s dhe operatorëve, megjithatë duhet të përfshihen në një ligj, në vend të asaj që një pjesë e tyre të përfshihet në LNK, ndërsa pjesa tjetër në Ligjin për ASN. Fillimisht duhet të shqyrtohet mundësia që këto dispozita të inkorporohen në Ligjin për ndjekjen e komunikimeve si lex specialis për këtë problematikë.

### 3.2.2. Ndjekja e komunikimeve në interes të sigurisë dhe mbrojtjes

Organe të autorizuara për ndjekjen e telekomunikimeve në interes të sigurisë dhe mbrojtjes janë ASN dhe Ministria e Mbrojtjes - Shërbimi Ushtarak i Sigurisë dhe Zbulimit, si dhe Qendra për Vëzhgim Elektronik e ARM-së e caktuar për nevojat e mbrojtjes (në pjesën e spektrit frekuent të frekuencave të larta, shumë të larta dhe ultra të larta). Urdhër për ndjekjen e komunikimeve nxjerr gjyqtari i Gjykatës Supreme i përcaktuar me orarin e brendshëm të Gjykatës, në bazë të kërkesës së drejtorit të ASN-së, përkatësisht me propozim të Ministrit të Mbrojtjes ose të personit të autorizuar nga ministri.

#### MASAT PËR NDJEKJEN E KOMUNIKIMEVE NË INTERES TË SIGURISË DHE MBROJTJES

Në kapitullin për ndjekjen e komunikimeve në interes të sigurisë dhe mbrojtjes, ligjvënësi ka përcaktuar katër masa të reja për ndjekjen e komunikimeve, siç janë:

- Ndjekja dhe regjistrimi i komunikimeve telefonike dhe i komunikimeve të tjera elektronike;
- Mbikëqyrja dhe regjistrimi teknik i brendësisë së objektit, i hapësirave të mbyllura dhe sendeve dhe hyrjes në ato objekte, hapësirave të mbyllura dhe sendeve, me qëllim të krijimit të kushteve për zbatimin e masës;
- Ndjekja dhe mbikëqyrja me regjistrim ndriçues të personave në hapësirë të hapur dhe në vende publike;
- Ndjekja dhe mbikëqyrja me regjistrim tonik të përmbajtjes së komunikimeve të personave në hapësirë të hapur dhe në vende publike.

Një pjesë e masave të përcaktuara të reja, sipas natyrës së tyre, megjithatë nuk përputhen plotësisht me përkufizimin e ndjekjes së komunikimeve në kuptimin e LNK-së dhe bëjnë pjesë në domenin e disa prej autorizimeve policore të përcaktuara në nenin 28 paragrafin 1 të Ligjit për policinë.<sup>18</sup> Rregullimi i këtillë lë mundësi për mbivendosje në praktikë të autorizimeve të besuara policore dhe masave të shqiptuara për ndjekjen e komunikimeve.

#### REKOMANDIM

Duhet të rishikohen masat e parashikuara në nenin 18 të LNK-së me qëllim që të diferencohen nga veprimet të cilat përputhen me autorizimet policore të përcaktuara në Ligjin për polici.

<sup>18</sup> Ligji për polici, "Gazeta Zyrtare" nr. 114/06, 114/06, 6/09,145/12, 41/14, 33/15, 31/16, 106/16, 120/16, 21/18, 64/18

## KUSHTET PËR NDJEKJEN E KOMUNIKIMEVE NË INTERES TË SIGURISË DHE MBROJTJES

Në nenin 19 paragrafin 1 të LNK-së është përcaktuar se masat për ndjekjen e komunikimeve në interes të sigurisë dhe mbrojtjes do të zbatohen kur ekzistojnë baza të dyshimit se përgatitet kryerja e veprës penale kundër shtetit, kundër forcave të armatosura ose kundër njerëzimit dhe së drejtës ndërkombëtare. Përfshirja në mënyrë joselektive në këtë kornizë të të gjitha veprave penale kundër forcave të armatosura nuk korrespondon me parimet ndërkombëtare, të cilat e nënkuptojnë zbatimin e teknikave speciale hetuese vetëm për sa u përket formave më të rënda të krimit.<sup>19</sup> Me fjalë të tjera, vetëm për një pjesë të vogël të veprave penale kundër forcave të armatosura Kodi Penal parashikon dënim deri në pesë vjet, ndërsa për shumicën e tyre dënimi është nga një deri tre vjet me mundësi për shqiptimin e dënimit disiplinor nëse vepra është specifikuar si e llojit të lehtë dhe nëse këtë e kërkojnë interesat e shërbimit.

### REKOMANDIM

- Duhet të shmangen veprat penale të cilat nuk bëjnë pjesë në përkufizimin e veprave të rënda penale të përcaktuara në Konventën e Krimit të Organizuar Transnacional të Organizatës së Kombeve të Bashkuara,<sup>20</sup> si dhe në Rekomandimin e Këshillit të Ministrave pranë Këshillit të Evropës për parimet kryesore të luftës kundër krimit të organizuar.<sup>21</sup>

## VEPRIMI PARANDALUES

Në paragrafin 2 të nenit 19 nga LNK, është parashikuar zbatimi i masave për ndjekjen e komunikimeve edhe për shkak të veprimit parandalues kur përgatitet, stimulohet, organizohet ose merret pjesë në sulm të armatosur kundër shtetit ose paaftësimin e sistemit të tij të sigurisë; si dhe sa u përket aktiviteteve të veprave penale organizatë terroriste, terrorizëm dhe financim të terrorizmit, nëse në mënyrë tjetër nuk mund të sigurohen informacione për aktivitetin e këtillë ose kjo do të ndërliqej me vështirësi më të mëdha.

### REKOMANDIM

- Zbatimi parandalues ose preventiv i masave për ndjekjen e komunikimeve meriton qasje më serioze dhe kjo çështje duhet të rregullohet në mënyrë shumë më precize meqë kjo e nënkupton zbatimin e masave skajshëm invazive vetëm në bazë të indicjeve, pa ekzistuar as baza të dyshimit, që gjithsesi lë hapësirë për dyshime në mundësinë për cenimin e të drejtave personale të individëve.

<sup>19</sup> Council of Europe Recommendation (2005) 10 of the Committee of Ministers to member states on “special investigative techniques” in relation to serious crimes including acts of terrorism

<sup>20</sup> The United Nations Convention Against Transnational Organized Crime (2000)

<sup>21</sup> Council of Europe Recommendation (2001) 11 of the Committee of Ministers to member states concerning guiding principles of the fight against organized crime

## META TË DHËNA

Në një kapitull të veçantë të titulluar “Meta të dhëna” ligjvënësi e ka parashikuar detyrimin për operatorët, me kërkesë të organeve të autorizuara t’u dërgojnë meta të dhëna, për nevojat e sigurisë dhe mbrojtjes. Për këtë kërkesë duhet të njoftohet Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut i cili nëse nuk e konfirmon arsyeshmërinë e të dhënave, atëherë organi i autorizuar do ta ketë për detyrë që menjëherë ta ndërpresë përdorimin e të dhënave dhe t’i shkatërrojë ato.

Bëhet fjalë për të dhëna të cilat operatorët i ruajnë konform Ligjit për komunikime elektronike (LKE).<sup>22</sup> Megjithatë, këto dispozita të LNK-së të formuluar në këtë mënyrë, si edhe dispozitat e LKE-së, mundësojnë që të gjitha organet e ndjekjes së komunikimeve, pa urdhër gjyqësor ose vendim të prokurorit publik, të realizojnë këqyrje në meta të dhënat në mënyrë joselektive për të gjithë qytetarët.

Në ndërkohë, Direktiva 2006/24/KE e cila në këtë mënyrë u transponua në legjislacionin tonë, u anulua me aktgjykimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë,<sup>23</sup> me arsyetimin se qeveritë nuk mund t’i detyrojnë kompanitë e telekomunikimeve t’i ruajnë të gjitha të dhënat e klientëve të tyre dhe se ruajtja joselektive dhe masive e meta të dhënave nuk korrespondon me Kartën e BE-së për të Drejtat Themelore.

Një çështje tjetër diskutabile lidhur me meta të dhënat ka të bëjë me atë që “Këqyrje në komunikimet e realizuara telefonike dhe në komunikimet e tjera elektronike” që padyshim paraqesin meta të dhëna, është masa MPH e cila në përputhje me nenin 252 paragrafin 1 pikën 6 të LPP-së zbatohet sipas urdhrit të prokurorit publik. Kundrejt kësaj mase MPH, në nenin 287 paragrafin 8 të LPP-së pa nevojë është përcaktuar detyrimi për operatorët, me kërkesë të prokurorit publik të dërgojnë meta të dhëna të cilat ata i ruajnë. Përcaktimi i këtij detyrimi në kushte kur tanimë ekziston në formë të masës MPH në ligjin e njëjtë, krijon mundësi për anashkalimin e mekanizmave mbrojtës të parashikuar me masat MPH dhe njëkohësisht, si edhe në rastin e masës së përmendur MPH, mundësi që të realizohet këqyrje në meta të dhënat pa urdhër gjyqësor.

## REKOMANDIM

Dispozitat me të cilat janë rregulluar meta të dhënat në disa ligje (LNK, LKE, LPP) duhet të rishikohen, me ç’rast duhet të merret parasysh praktika e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, por edhe qëndrimi i Komisionit të Venecias për meta të dhënat, të përfshira në Listën e kontrollit të Sundimit të së drejtës.<sup>24</sup> Njëra nga zgjidhjet alternative të rregullimit të kësaj problematike mund të jetë, si më poshtë:

- Këqyrja në meta të dhënat të përfshihet në përkufizimin e ndjekjes së komunikimeve dhe të praktikohet në bazë të urdhrit paraprakisht të lëshuar gjyqësor në kushte dhe procedurë të cilat

<sup>22</sup> Konform nenit 176, 177 dhe 178 të LKE bëhet fjalë për të dhëna të cilat operatorët e kanë për detyrë t’i ruajnë 12 muaj nga dita e realizimit të komunikimit, në formë të regjistrimit elektronik për çdo qasje të qytetarëve të çdo lloji në komunikimin elektronik dhe të njëjtat përmbajnë informacion për emrin, numrin e telefonit ose për IP adresën, lokacionin e personave që komunikojnë, në cilën kohë është zhvilluar komunikimi etj.

<sup>23</sup> Judgment of the Court (Grand Chamber) of 8 April 2014 Digital Rights Ireland Ltd (C-293/12) v Minister for Communications, Marine and Natural Resources, Minister for Justice, Equality and Law Reform, The Commissioner of the Garda Síochána, Ireland and The Attorney General, and Kärntner Landesregierung, Michael Seitlinger, Christof Tschohl and Others (C-594/12)

<sup>24</sup> European Commission for Democracy through Law (Venice Commission) Rule of Law Checklist, March 2016, i akseeshëm në: [https://www.venice.coe.int/images/SITE%20IMAGES/Publications/Rule\\_of\\_Law\\_Check\\_List.pdf](https://www.venice.coe.int/images/SITE%20IMAGES/Publications/Rule_of_Law_Check_List.pdf)

vlejnë për të gjitha masat e tjera të ndjekjes së komunikimeve (për hetimet penale dhe për sigurinë dhe mbrojtjen). Rishikimi gjithsesi se do të ketë nevojë për ndryshimin e nenit 252 paragrafit 1 të LPP-së kështu që masa MPH nga pika 6 do të shqiptohet me urdhër gjyqësor, si dhe ndryshime në nenin 32 dhe 33 të LKE-së. Në këtë drejtim, neni 287 paragrafi 8 i LPP-së do të duhet të shfuqizohet.

### RUAJTJA DHE SHKATËRRIMI I TË DHËNAVE

Afati i ruajtjes së të dhënave të grumbulluara përmes ndjekjes së komunikimeve në interes të sigurisë dhe mbrojtjes nga pesë vitet paraprake, që u vlerësua si periudhë tepër e gjatë nga ana e Grupit të Ekspertëve të udhëhequr nga Pribe, tani është tre vjet (neni 29 paragrafi 1 i LNK-së). Së këtejmi, në përputhje me nenin 29 paragrafin 2 të LNK ky afat mund të fillojë përsëri të rrjedhë në rast të pranimit të ndonjë informacioni të ri i cili në mënyrë të drejtpërdrejt ndërlidhet me të dhënat specifike për të cilat akoma nuk ka skaduar periudha e ruajtjes. Përveç kësaj, në nenin 29 paragrafin 5 theksohet se “të gjitha të dhënat në regjistrin gjyqësor për personin për të cilin ka të bëjë urdhri ruhen 10 vjet, ndërsa pas skadimit të afatit shkatërrohen”.

### REKOMANDIM

- Në nenin 29 paragrafin 1 mund të përcaktohet afat i arsyeshëm shtesë dhe pas skadimit të këtij afati të dhënat të shkatërrohen në mënyrë përkatëse, që të pamundësohet ruajtja e tyre pakufi edhe lënia hapësirë për keqpërdorime eventuale.
- Duhet të rishikohet kohëzgjatja prej 10 vitesh e cila është përfshirë në nenin 29 paragrafin 5 të cituar më lart nga LNK dhe në nenin 67 paragrafin 2 nga LNK.
- Neni 29 duhet të plotësohet me dispozita në të cilat do të specifikohen masat e sigurisë të përcaktuara me ligjin e lartpërmendur LMDhP dhe Direktivën 2016/680, që gjithsesi korrespondon me rekomandimin nga “Raporti i Pribes” për përforcimin e sigurisë të të dhënave dhe ruajtjen e tyre nën regjim të veçantë.
- Duhet të përcaktohet edhe detyrimi për shkatërrimin e regjistrimit origjinal, si dhe të të gjitha kopjeve në të gjitha institucionet dhe subjektet e përfshira në përcjelljen dhe ndjekjen e komunikimeve.

### 3.2.3. Mbikëqyrja dhe kontrolli mbi ndjekjen e komunikimeve

#### MBIKËQYRJA MBI MASAT PËR NDJEKJEN E KOMUNIKIMEVE

Mbikëqyrja mbi ndjekjen e komunikimeve është një proces kompleks në të cilin nga trupat mbikëqyrës pritet të veprojnë si korrektorë të mirëfilltë të punës së shërbimeve të sigurisë. Në të kundërtën, ndjekja e komunikimeve pa mbikëqyrje përkatëse në mënyrë serioze mund ta vë në pikëpyetje respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe të krijojë ambient të pasigurisë. Mbikëqyrja duhet të zhvillohet në vazhdimësi përmes një praktike të vendosur me trupa mbikëqyrës të cilët janë të liruar nga ndikimet partiake dhe politike. Së këtejmi, mbikëqyrja nuk duhet të nënkuptohet vetëm si paraqitje të raporteve vjetore në Parlament, edhe pse Ligji paraprak për ndjekjen e komunikimeve nuk kishte parashikuar më shumë mekanizma shtesë në funksion të mbikëqyrjes efikase.

Në LNK nga viti 2018 janë tejkualuar disa elemente të caktuara diskutabile, të cilat edhe pse në shikim të parë janë të karakterit teknik, megjithatë deri më tani e vështirësonin dhe në periudha të caktuara plotësisht e paralizonin mbikëqyrjen mbi ndjekjen e komunikimeve. Kjo fillimisht ka të bëjë me angazhimin e ekspertëve teknikë nacionalë dhe ndërkombëtarë me njohuri përkatëse profesionale, të cilët do të marrin pjesë në mbikëqyrjen si pjesë të Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrje mbi Zbatimin e Masave për Ndjekjen e Komunikimeve. Në drejtim të njëjtë është edhe lëshimi i certifikatës së sigurisë në procedurë e cila nuk do të zgjasë më shumë se 30 ditë (neni 37 paragrafi 2 nga LNK),<sup>25</sup> dhe për këtë qëllim në vitin 2018 në mënyrë përkatëse u plotësua Ligji i atëhershëm për informacione të klasifikuara. Është me rëndësi edhe ajo se Komisioni Parlamentar e bën mbikëqyrjen pa lajmërim paraprak, sipas nevojës, dhe më së paku një herë në tre muaj, madje edhe në mungesë të shumicës së votave (neni 44 paragrafi 1 nga LNK). Gjatë kohës së kryerjes së mbikëqyrjes Komisioni mund të kërkojë mbështetje nga ekspertë nga çdo institucion dhe organ shtetëror i cili nuk është objekt i mbikëqyrjes, në mesin e të cilëve edhe Agjencia për Komunikime Elektronike, Drejtoria për Sigurinë e Informacioneve të Klasifikuara dhe Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për çështje në kompetencë të tyre.

Kundrejt këtyre elementeve, inkorporimi i të cilave në dispozitat ligjore ishte e domosdoshme, fitohet përshtypje se Komisioni kompetent parlamentar megjithatë ka autorizime të kufizuara që mund ta vë në pikëpyetje mbikëqyrjen cilësore dhe gjithëpërfshirëse. Me fjalë të tjera, Komisioni por edhe ekspertët e akredituar teknikë, gjatë kryerjes së mbikëqyrjes mund të bëjnë krahasim të logove për kohën dhe datën e fillimit dhe përfundimit të ndjekjes së komunikimeve, të cilat si të dhëna mund të merren nga operatorët, ATO dhe organet e autorizuar. Nga ATO dhe nga organet e autorizuar, për Komisionin është i aksesshëm edhe urdhri i anonimizuar gjyqësor (urdhri me shkrim i rregullt dhe i përkohshëm), ndërsa nga ATO edhe logot për numrin e përgjithshëm të masave të zbatuara për ndjekjen e komunikimeve për një periudhë të caktuar kohore. Me qasjen në të dhënat e theksuara, Komisioni dhe ekspertët teknikë megjithatë nuk kanë këqyrje në të dhënat për identitetin e personit, për numrin e telefonit, e-mail adresën etj. Nga këto shkaqe, gjatë kryerjes së mbikëqyrjes Komisioni dhe ekspertët teknikë nuk mund t'i krahasojnë të dhënat e urdhrit të lëshuar gjyqësor me ndjekjen reale të aktivizuar të komunikimeve për personin konkret, numrin e telefonit ose e-mail adresën. Në mungesë të mundësisë për një krahasim të këtillë, Komisioni si trup mbikëqyrës nuk mund të konstatojë nëse ndonjë person ose ndonjë mjet komunikimi është ndjekur në mënyrë të paligjshme.

Në krahasim me legjisllacionin e R. së Kroacisë, sipas modelit të të cilëve është krijuar legjisllacioni ynë, Këshilli kompetent për siguri nacionale si njëri nga trupat përmes të cilit Parlamenti Kroat bën mbikëqyrje mbi agjencitë e sigurisë dhe zbulimit, përfshirë këtu edhe mbi grumbullimin e fshehtë të të dhënave, ka autorizime më të gjëra në masë të konsiderueshme. Përveç këqyrjes në raportet për aktivitetet dhe masat që i ndërmarrin agjencitë e sigurisë, Këshilli mund të kërkojë nga Gjykata Supreme e Kroacisë dhe nga agjencitë e sigurisë dhe zbulimit raport për masat e ndërmarra për grumbullimin e fshehtë të të dhënave dhe për masat e ndërmarra ndaj personave të caktuar, mund ta thërrasin drejtorin dhe të punësuarit në agjencitë e sigurimit në mbledhje dëgjimore në lidhje me ligjshmërinë e masave të ndërmarra, si dhe të diskutojë për ligjshmërinë e punës financiare dhe materiale të agjencive të sigurisë dhe zbulimit. Ky trup kryen edhe mbikëqyrje të drejtpërdrejtë

<sup>25</sup> Edhe pse, neni 37 paragrafi 2 i LNK nuk është formuluar në mënyrë përkatëse. Afati prej 30 ditësh të kohëzgjatjes së procedurës, ndërsa certifikatë sigurie mundet edhe të mos lëshohet, nëse vlerësimi i sigurisë e imponon një gjë të këtillë.

mbi agjencitë e sigurisë dhe zbulimit edhe atë në përputhje me dispozitat e njëjta të Ligjit për sistemin e sigurisë dhe zbulimit të Republikës së Kroacisë të cilat janë parashikuar për mbikëqyrje profesionale e cila kryhet nga Zyra e Këshillit të Sigurisë Nationale. Nga aspekti i legjislationit kroat, mbikëqyrja e drejtpërdrejtë nënkupton mbikëqyrje mbi ligjshmërinë e punës së agjencive të sigurisë-zbulimit, mbi realizimin e qëllimeve të përcaktuara dhe fushëveprimin e punës, mbi zbatimin e masave për grumbullimin e fshehtë të të dhënave, mbi mjetet financiare, si dhe mbi bashkërenditjen dhe bashkëpunimin midis agjencive të sigurisë-zbulimit dhe shërbimeve përkatëse të shteteve tjera. Përveç kësaj, në përputhje me nenin 108 të Ligjit për sistemin e sigurisë-zbulimit të R. të Kroacisë, në kuadër të mbikëqyrjes profesionale është përcaktuar autorizim që trupat mbikëqyrës të kërkojnë nga agjencitë e sigurisë të dhëna për identitetin e burimit të organeve të autorizuar kur një gjë e këtillë është e domosdoshme për qëllimet e realizimit të mbikëqyrjes në rastin konkret, me ç'rast nëse ka mospajtim nga ana e agjencive me kërkesën e këtillë, atëherë vendos Këshilli i Sigurisë Nationale.

Edhe pse ky sistem i ndjekjes së komunikimeve ishte modeli sipas të cilit u vendosën bazat e sistemit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, megjithatë LNK është restriktiv në përcaktimin e autorizimeve të Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrje ndërsa një pjesë e konsiderueshme të zgjidhjeve ligjore të sistemit kroat nuk janë përfshirë në legjislationin tonë. Shqetëson fakti se bëhet fjalë për mekanizma të cilët mund të kontribuojnë për një mbikëqyrje efikase dhe në rritjen e besimit ndaj punës së Komisionit Parlamentar, si dhe ndaj shërbimeve të sigurisë.

## REKOMANDIM

- Duhet të shqyrtohet mundësia për plotësimin e nenit 42 të LNK-së në lidhje me përcaktimin e autorizimit për Komisionin dhe ekspertët teknikë, ose vetëm për ekspertët teknikë, gjatë zbatimit të mbikëqyrjes të kenë qasje edhe në instalimet e ATO-s me mundësi për këqyrje edhe në urdhrat e pa-anonimizuar gjyqësorë.
- Gjatë numërimit taksativ të të dhënave në nenin 41, 42 dhe 43 të LNK-së duhet të përcaktohet mundësia e këqyrjes edhe në dokumentacionin dhe të dhënat e tjera për të cilat do të shfaqet nevoja gjatë mbikëqyrjes, të cilat nuk mund të parashikohen gjatë përpilimit të dispozitave ligjore.
- Neni 40 i LNK-së duhet të plotësohet me dispozita të cilat do t'i mundësojnë Komisionit për Mbikëqyrje mbi Masat për Ndjekjen e Komunikimeve një spektër më të gjerë të autorizimeve dhe veprimeve të cilat do t'i ndërmerr, veçanërisht në drejtim të thirrjes në bisedë të personave udhëheqës dhe të punësuarve të tjerë në organet e autorizuar dhe në ATO në rastin kur ka nevojë për informacione plotësuese lidhur me ligjshmërinë e zbatimit të masave konkrete (siç është parashikuar për trupin kompetent punues të Kuvendit për mbikëqyrje mbi ASN, në përputhje me nenin 60 paragrafin 5 të Ligjit për ASN), si dhe mundësi për t'i thërritur personat udhëheqës dhe të punësuar të tjerë në organet e autorizuar dhe në ATO në mbledhje të Komisionit ku ata do të mund të përgjigjen në pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Komisionit, por edhe nga ekspertët teknikë.

- Në nenin 40 të LNK-së duhet të përfshihet edhe mbikëqyrja mbi efikasitetin gjatë zbatimit të masave për ndjekjen e komunikimeve në kuptim të përdorimit efikas të kapaciteteve financiare dhe njerëzore, ndërsa efektiviteti i mbikëqyrjes duhet të përcaktohet si objektivi edhe sa u përket masave për ndjekjen e komunikimeve në interes të sigurisë dhe mbrojtjes.

Përveç kësaj që u tha më lart, duhet të përpilohen edhe akte përkatëse normative nënligjore me të cilat do të përcaktohet metodologjia e realizimit të vizitave në terren dhe do të përcaktohen pasojat nëse komisionet nuk paraqesin ose vonohen me paraqitjen e raportit të Kuvendit, afatet brenda të cilëve organeve të autorizuara duhet t'u dërgohen informacionet e kërkuara, si dhe pasojat nga dërgimi me vonesë. Veç tjerash, duhet të krijohen mekanizma përmes të cilëve do të rritet vetëdija tek anëtarët e komisioneve për rëndësinë e mbikëqyrjes parlamentare mbi ndjekjen e komunikimeve dhe mekanizma përkatës përmes të cilëve anëtarët do të lirohen nga ndikimet partiake dhe politike gjatë kryerjes së mbikëqyrjes.

### **KËSHILLI I MBIKËQYRJES QYTETARE**

Këshilli i mbikëqyrjes qytetare u promovua në nenin 35 të LNK-së si një trup i ri i cili bën mbikëqyrje mbi ligjshmërinë e masave për ndjekjen e komunikimeve dhe mbi ATO-n, me iniciativë të vet ose sipas parashtresës së parashtruar nga qytetari. LNK konkretisht nuk e rregulloi statusin dhe kushtet e punës të këtij trupi, përveç atë se hapësirat e punës së Këshillit i siguron Kuvendi, ndërsa mjetet financiare sigurohen nga Buxheti i shtetit. Për shkak të statusit të parregulluar, Këshilli i Mbikëqyrjes Qytetare nuk mund t'i ketë në dispozicion mjetet e akorduara buxhetore. Gjithsesi ky është njëri nga shkaqet që madje më shumë se një vit nga konstituimi, Këshilli i Mbikëqyrjes Qytetare nuk ka filluar së funksionuari në mënyrë serioze, nuk janë krijuar kushtet themelore për punë në aspektin e mjeteve të domosdoshme teknike, arkivi, kasaforta e sigurisë, regjistrimi i adresës e-mail, honorarë për anëtarët, si dhe certifikatat e sigurisë për një pjesë të anëtarëve. Në Kuvend u propozuan ndryshime të LNK-së sa u përket disa çështjeve normative që kanë të bëjnë me Këshillin, megjithatë ato akoma nuk janë miratuar. Në ndërkohë, për shkak të kësaj që u tha më lart, në tetor të vitit 2019 një anëtar i Këshillit paraqiti dorëheqje, ndërsa në qershor të vitit 2020 dorëheqje paraqitën kryetari dhe nënkryetari i Këshillit të Mbikëqyrjes Qytetare.

Sa u përket autorizimeve të Këshillit të Mbikëqyrjes Qytetare, LNK ka parashikuar kufizime të caktuara të cilat duhet të rishikohen, meqë mënyra aktuale e rregullimit të këtyre autorizimeve nuk garantojnë mbikëqyrje efikase qytetare dhe Këshillin e bëjnë trup jofunksional. Me fjalë të tjera, pas pranimit të parashtresës nga qytetari, Këshilli i Mbikëqyrjes Qytetare nuk ka mundësi të veprojë në mënyrë që të konstatojë nëse parashtresa është e bazuar, përkatësisht nëse ndonjë personi ose numri të telefonit komunikimet janë ndjekur në mënyrë të paligjshme. Në lidhje me parashtresën, Këshilli duhet të parashtrtojë kërkesë deri te Komisioni për Mbikëqyrje mbi Ndjekjen e Komunikimeve që ky të zbatojë mbikëqyrje dhe në lidhje me këtë ta njoftojë Këshillin në afat prej 15 ditësh. Relacioni i vendosur në këtë mënyrë midis Këshillit të Mbikëqyrjes Qytetare dhe Komisionit për Mbikëqyrje është kontestues dhe jo vetëm që e vë Këshillin në një pozitë të marginalizuar në raport me Komisionin, por edhe e vë në pikëpyetje arsyeshmërinë e ekzistimit të tij.



Së këtejmi, pozita e Këshillit të Mbikëqyrjes Qytetare është marginalizuar në mënyrë plotësuese me faktin se mbikëqyrja, e cila konform nenit 51 paragrafit 2 alinesë 2 të LNK-së, Këshilli megjithatë mund ta kryejë, duhet të lajmërohet paraprakisht dhe ta mbikëqyrë vetëm zbatimin e urdhrat të anonimizuar për 3 muajt e fundit. Kufizime të këtilla gjatë kryerjes së mbikëqyrjes në LNK nuk janë parashikuar as për Komisionin dhe as për trupat e tjerë mbikëqyrës.

Në aspektin komparativ, në Republikën e Kroacisë autorizimet e trupit mbikëqyrës të emërtuar Këshilli i Mbikëqyrjes Qytetare mbi agjencitë e sigurisë-zbulimit, nuk janë të kufizuara vetëm në mbikëqyrjen e ligjshmërisë së masave për ndjekjen e komunikimeve. Ky trup kryen mbikëqyrje edhe mbi punën e agjencive të sigurisë-zbulimit, i ndjek dhe kryen mbikëqyrje mbi masat e grumbullimit të fshehtë të të dhënave, grumbullon informacione dhe të dhëna konform autorizimeve të tij, etj. Nga ana tjetër, ky trup mund të kryejë këqyrje në raportet dhe dokumentet e tjerë të agjencive të sigurisë-zbulimit, të realizojë biseda me personat udhëheqës dhe me persona të tjerë zyrtarë të agjencive, ndërsa përveç iniciativave të veta dhe sipas parashtresës së qytetarëve, vepron edhe sipas kërkesave të autoriteteve shtetërore dhe personave të tjerë juridikë.

## REKOMANDIME

- Statusi i Këshillit të Mbikëqyrjes Qytetare duhet të rregullohet në mënyrë përkatëse me qëllim të krijimit të të gjitha parakushteve të nevojshme për funksionimin e tij efikas në kuptimin teknik dhe material. Njëra nga zgjidhjet e mundshme dhe logjike është që Këshilli të ketë status të trupit punues ose profesional në kuadër të Kuvendit.
- Paralelisht me rregullimin e statusit të Këshillit, duhet të rishikohen të gjitha kufizimet sa u përket autorizimeve të Këshillit të Mbikëqyrjes të përfshira në LNK aktuale. Së këtejmi, me që në reformën e sektorit të sigurisë-zbulimit si model u transponuan zgjidhjet ligjore nga Republika e Kroacisë, ato do të duhej të merren parasysh si pikë referimi për rishikimin e autorizimeve ligjore të Këshillit të Mbikëqyrjes Qytetare. Në këtë drejtim, Këshilli duhet t'i sigurohet që të veprojë në mënyrë të drejtpërdrejtë sipas pranimit të parashtresës nga qytetari, si dhe mbikëqyrje pa paralajmërim dhe pa kufizimin aktual kohor në lidhje me zbatimin e urdhrave gjyqësor. Gjithashtu, Këshilli duhet ta ketë të drejtën e këqyrjes në të gjitha të dhënat në të cilat ka akses Komisioni, si dhe këqyrje në instalimet e ATO-s dhe në urdhrat e paanonimizuar gjyqësorë. Për këtë qëllim dhe nëse Këshilli ka nevojë, duhet t'i mundësohet mbështetje nga ekspertët e akredituar teknikë, pavarësisht asaj se në përbërjen e këshillit mund të ketë edhe persona me arsim formal nga fusha e shkencave teknike, të cilët nuk është e thënë se duhet të jenë ekspertë në fushën e telekomunikimeve.
- Në perspektivë, në një kontekst më të gjerë të sektorit të sigurisë-zbulimit, ndërsa sipas modelit të Këshillit të Mbikëqyrjes Qytetare mbi agjencitë e sigurisë-zbulimit të R. të Kroacisë, duhet të shqyrtohet mundësia e zgjerimit të autorizimeve të Këshillit të Mbikëqyrjes Qytetare edhe mbi punën e shërbimeve të sigurisë-zbulimit, paralelisht me Komisionin Parlamentar për Mbikëqyrje mbi punën e ASN dhe Agjencisë së Zbulimit.



## KONTROLLI MBI NDJEKJEN E KOMUNIKIMEVE

Për dallim nga mbikëqyrja, kontrolli mbi ndjekjen e komunikimeve zbatohet në kuadër të organeve të jurisprudencës. Kontroll mbi ligjshmërinë e zbatimit të masave për ndjekjen e komunikimeve kryen prokurori publik i cili e udhëheq hetimin dhe gjyqtari i procedurës paraprake i cili e lëshon urdhrin për ndjekjen e komunikimeve si masë MPH, përkatësisht Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe gjyqtari i Gjykatës Supreme i cili e lëshon urdhrin për ndjekjen e komunikimeve në interes të sigurisë dhe mbrojtjes. Kontroll mbi mënyrën e përdorimit të instalimeve dhe pajisjeve të posaçme teknike nga neni 17 i LNK-së kryen Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe gjyqtari i procedurës paraprake i cili e lëshon urdhrin për ndjekjen e komunikimeve.

Në mënyrë identike si mbikëqyrja, edhe kontrolli është determinuar nga një sërë faktorësh, në mesin e të cilëve veçanërisht është e rëndësishme pavarësia e trupave kontrollues.

Në funksion të kontrollit efikas, trupat kontrollues, si edhe ato mbikëqyrës, mund të angazhojnë ekspertë teknikë dhe kontrollin ta kryejnë sipas nevojës, por edhe pa paralajmërim. Në nenin 59 të LNK-së, janë përcaktuar aktivitetet të cilat trupat kontrollues mund t'i ndërmarrin në kuadër të kompetencave të tyre, siç është kryerja e këqyrjes në vendin ku janë stacionet e punës, të cilat i shfrytëzojnë organet e autorizuar, në hapësirat e ATO-s, aty ku është pajisja për ndjekjen e komunikimeve dhe instalimet për ndërmjetësim, por edhe në vendin ku operatorët i ruajnë instalimet për përcjelljen e sinjalit deri te ATO. Po ashtu, mund të kërkojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë të kenë qasje në sistemin e regjistrimit elektronik; të kërkojnë këqyrje ose të marrin një kopje nga regjistri në formë të shkruar edhe nga urdhri i anonimizuar për ndjekje; t'i lexojnë të gjitha logot e krijuara, të regjistruara ose të ruajtura nga sistemet që i përdor ATO dhe operatorët, etj.

Në mënyrë plotësuese, në kontekst të kontrollit të prokurorit publik janë edhe dispozitat e nenit 258 të LNK-së sipas të cilave gjatë kryerjes së masave MPH, policia gjyqësore përpilon raport të cilin ia dërgon prokurorit publik me kërkesë të tij dhe në çdo rast për 30 ditë, ndërsa pas zbatimit të masave përpilon edhe raport përfundimtar, të cilit ia bashkëngjitet dokumentacionin e plotë të regjistrimit teknik, dhe ia dërgon prokurorit publik. Prokurori publik, raportin dhe dokumentacionin e plotë pas miratimit të vendimit nga prokurori publik në afat prej tetë ditësh ia dërgon gjykatës.

Sa i përket zbatimit të masave MPH në përgjithësi, duke e përfshirë edhe masën për ndjekjen e komunikimeve, LPP në nenin 271 e obligon Prokurorin Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut një herë në vit t'i paraqesë raport Kuvendit në të cilin do t'i theksojë të dhënat për të gjitha 8 pikat që i përfshin neni 271 nga LPP.

Në praktikë, raportet vjetore për zbatimin e masave MPH Prokurori Publik i dërgon në Kuvend zakonisht në afat prej shtatë deri nëntë muaj pas skadimit të vitit përkatës, që është mjaft joadekuate. Përveç kësaj, këto raporte nuk publikohen në ueb-faqen e Prokurorisë Publike dhe më së shpeshti nuk i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 271 të LPP-së. Mungojnë të dhëna për atë se sa propozime për ndjekjen e komunikimeve i janë dërguar prokurorit publik, me sa prej tyre është pajtuar prokurori publik, sa iniciativa personale ka pasur për ndjekjen e komunikimeve dhe për sa nga kërkesat e parashtruara është lëshuar urdhër gjyqësor. Gjithashtu, në raporte nuk janë theksuar shkaqet për rastet kur

ndjekja e komunikimeve nuk ka dhënë rezultate relevante, ashtu siç në të vërtetë nuk janë theksuar edhe të dhënat e shpenzimeve që rezultojnë nga zbatimi i masave MPH, përfshirë këtu edhe masën ndjekje të komunikimeve.

## REKOMANDIM

- Në interes të transparencës do të ishte e dobishme të përcaktohet një afat i arsyeshëm kohor në të cilin Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut do ta ketë për detyrë ta paraqes raportin vjetor për zbatimin e masave MPH në Kuvend me të gjitha elementet e nevojshme dhe të njëjtit t'i publikojë në ueb-faqen e Prokurorisë Publike.

**Nga ana tjetër**, gjyqtari në funksion të kontrollit mbi ligjshmërinë e zbatimit të masave për ndjekjen e komunikimeve duhet të ketë një qasje jashtëzakonisht të kujdesshme sa i përket lëshimit të urdhrave për ndjekjen e komunikimeve me ç'rast duhet të bëjë një vlerësim objektiv nëse në rastin konkret këto masa kërkohen si alternativë e fundit, *ultimaratio*, dhe jo si opsion i cili do të zbatohet që në fazën e hershme të ndjekjes penale, pa i absolvuar mjetet e tjera.

Gjyqësorit në Republikën e Maqedonisë së Veriut në përgjithësi i adresohen vërejte se ka shkallë të ulët të kritikizmit dhe thua se rregullisht dështon në rastet kur duhet të paraqitet si kontrollor i policisë dhe prokurorisë publike. Si pika kritike për gjendjen e këtillë theksohet zgjedhja, shkarkimi dhe transferimi i gjyqtarëve. Në këtë drejtim është edhe fakti se nga fillimi i zbatimit të masave MPH në shtetin tonë, nuk ka rast të vendimit të miratuar gjyqësor me të cilin është refuzuar kërkesa e prokurorit publik për zbatimin e masës konkrete.

Përvojat e deritanishme me kontrollin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve publikë e imponojnë nevojën për përcaktimin e mekanizmave të caktuar, me qëllim të ngritjes së vetëdijes për rolin proaktiv të prokurorëve publikë dhe të gjyqtarëve në ndjekjen e komunikimeve, jo vetëm si kontroll mbi ligjshmërinë e zbatimit të masave dhe këqyrjes rrjedhëse në raportet për zbatimin e tyre, por edhe si kontroll përmes parashtrimit të kërkesës për pëlqim, përkatësisht përmes nxjerrjes së urdhrave për ndjekjen e komunikimeve. Gjyqtarët dhe prokurorët publikë doemos në mënyrë thelbësore duhet ta kuptojnë lëndën me ç'rast duhet t'i kenë parasysht të gjitha parimet ndërkombëtare kur paraqesin kërkesë, përkatësisht kur nxjerrin urdhër për ndjekjen e komunikimeve, veçanërisht parimet e proporcionalitetit dhe subsidiaritetit, dhe me parimin që ndërlidhet me këto *ultio ratio* i cili nënkupton shqiptim të masave invazive si alternativë e fundit dhe mjet i fundit.

## 4. MUNDËSI DHE SFIDA

Reformat në fushën e ndjekjes së komunikimeve, si pjesë e reformës gjithëpërfshirëse të sektorit të sigurisë-zbulimit, padyshim se bëhet fjalë për një proces kompleks i shoqëruar me sfida dhe me rreziqe më pak ose më shumë të pritshme të cilat mund ta determinojnë suksesin e ndërhyrjeve të reformave.

Në sistemin e reformuar të ndjekjes së komunikimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë evidente mbivendosjet e kompetencave dhe ndarja pamjaftueshëm qartë e autorizimeve midis shërbimeve të caktuara. Sistemi e ruajtji strukturën komplekse paraprakisht të vendosur në një varg organe të autorizuar për ndjekjen e komunikimeve në funksion të hetimeve penale dhe në interes të sigurisë dhe mbrojtjes. Megjithatë, sigurimi i Drejtorisë së Doganave dhe Drejtorisë së Policisë Financiare me resurset e nevojshme materiale dhe njerëzore në funksion të ndjekjes ligjore të komunikimeve, zhvillohet ngadalë. Thuaja se dy vjet pas fillimit të zbatimit të LNK-së, ndjekja për nevojat e këtyre organeve akoma realizohet përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme, ashtu siç ishte edhe para reformave.

Sipas përvojave të deritanishme, ndikimet partiake dhe politike mbi shërbimet e sigurisë ndonjëherë e determinojnë punën e tyre. Me këtë vihet në pikëpyetje profesionalizmi i shërbimeve si dhe rrënohet besimi tek qytetarët. Procesi i vetingut gjatë transformimit të shërbimeve të caktuara (DSK-ASN) ishte sfidë e madhe dhe duhej ta mundësojë depolitizimin e tyre. Megjithatë, u theksuan disa vërejte, veçanërisht nga opozita parlamentare, të shoqëruara me akuza se kjo zgjedhje e kuadrove është i komprometuar dhe bazohet në kritere subjektive dhe politike, në vend që të bazohet në kritere objektive, të qarta dhe paraprakisht të përcaktuara.

Në segmentin e mbikëqyrjes dhe kontrollit hapi pozitiv në aspektin normativ, megjithatë, në praktikë realizohet ngadalë. Komisioni për Mbikëqyrje mbi Zbatimin e Masave për Ndjekjen e Komunikimeve akoma nuk është ekipuar me ekspertët teknikë edhe përkrah detyrimit ligjor që këtë ta bëjë menjëherë pas formimit të tij dhe jo më vonë se 50 ditë (neni 39 paragrafi 2 nga LNK). Në konkurs publik u zgjodh njëri nga kandidatët e paraqitur, ndërsa për zgjedhjen e ekspertit të dytë, konkursi u përsërit. Në mungesë të informacioneve publikisht të aksesshme për rezultatin e procedurës së konkursit, informatat jozyrtare kanë të bëjnë me atë se eksperti i dytë akoma nuk është zgjedhur.

Nga ana tjetër, nga Këshillit i Mbikëqyrjes Qytetare pritej se do të jetë korrektor i rëndësishëm mbi subjektet e involvuara në procesin e ndjekjes së komunikimeve, veçanërisht për shkak të faktit se ky trup mbikëqyrës përbëhet nga ekspertë dhe përfaqësues të sektorit joqeveritar. Megjithatë, pas konstituimit, përveç realizimit të disa aktiviteteve protokollare, Këshilli nuk ndërmori aktivitete të tjera me rëndësi esenciale, e që gjithsesi është rezultat i pengesave sa i përket funksionimit të tij. Këto gjendje janë tregues se përpjekjet për veprim në përputhje me ligjet reformuese, megjithatë nuk shkaktuan zhvendosje më serioze nga praktika e zakonshme e deritanishme.

Këto gjendje çojnë në konstatimin se mbikëqyrja si mekanizëm i fuqishëm i cili duhet të sigurojë llogaridhënie të shërbimeve të sigurisë, nuk mund të jetë efikas nëse për një gjë të këtillë nuk ka vullnet politik, kulturë politike dhe nivel të ndërgjegjësimit për nevojën e mbikëqyrjes mbi shërbimet e sigurisë. Vet fakti që Komisioni Parlamentar për Mbikëqyrje mbi Ndjekjen e Komunikimeve ka

përbërje mikse (përfaqësues nga opozita dhe pozita) dhe veçanërisht që kryetari i Komisionit është nga radhët e partisë opozitare, është mekanizëm plotësues i cili duhet të sigurojë efikasitet në kryerjen e mbikëqyrjes. Megjithatë, në këtë kuptim nuk mund të vërehet proaktivitet i konsiderueshëm. Që të ballafaqohen me sfidën e mbikëqyrjes mbi shërbimet e sigurisë, deputetët si anëtarë të komisioneve mbikëqyrëse medoemos duhet t'i vënë në plan të dytë interesat e ngushta partiake dhe ato të politikës ditore.

Gjatë kontrollit të kryer të rregullt të Komisionit për Mbikëqyrje mbi Zbatimin e Masave për Ndjekjen e Komunikimeve në korrik të vitit 2019 në hapësirat e ATO-s, në konferencën e përbashkët për shtyp të kryetarit të Komisionit dhe drejtorit të ATO-s u konstatua se ndjekja e komunikimeve është maksimalisht e sigurt dhe pa mundësi për keqpërdorime.<sup>26</sup> Megjithatë, kohë më parë, ministri aktual (teknik) i Punëve të Brendshme e informoi publikun se kabloja optike e cila mundëson të kuptohet përmbajtja e komunikimeve të ndjekura në funksion të hetimeve penale, fizikisht akoma kalon përmes selisë së ish-DSK-së, ku tani është selia e ASN-së së re. Konstatimi i ministrit korrespondon me atë se nuk është realizuar segmenti thelbësor i reformës - ndarja e monitorimit të komunikimeve në funksion të hetimeve penale, nga ndjekja në interes të sigurisë dhe mbrojtjes. ATO dhe ASN i mohuan këto pretendime, megjithatë, publiku i gjerë mbeti i painformuar për rezultatin nga kallëzimi penal i paraqitur nga ministri i Punëve të Brendshme deri te Prokuroria Publike në lidhje me pretendimet. Në lidhje me pretendimet e tjera të publikuara në vitin 2018, në lidhje me instalimet e zbuluara për regjistrimin e komunikimeve të telefonave fiks në Prokurorinë Publike dhe në Gjykatën Penale në Shkup, publiku i gjerë gjithashtu nuk është informuar për rrjedhën e procedurës para hetimore e cila u hap, dhe as për atë nëse eventualisht Komisioni për Mbikëqyrje mbi Zbatimin e Masave për Ndjekjen e Komunikimeve ndërmoi veprime në lidhje me këtë rast.

<sup>26</sup> <https://ota.mk/mk/190719-pretstavnic-i-sobranie-poseta-ota>

## 5. PIKËPAMJE DHE REKOMANDIME PËRFUNDIMTARE

Procesi i hartimit të legjislacionit të ri për ndjekjen e komunikimeve kishte qasje të entuziazmit të madh dhe bindje se do të ketë sukses synimi që të krijohet një sistem i balancuar i cili do të jetë efikas sa i përket funksionit për shkak të të cilit ekziston, ndërsa njëkohësisht do ta sigurojë respektimin e të drejtave themelore të njeriut. Konstatimi i përgjithshëm korrespondon me atë se u pasqyruan zgjidhje ligjore nga sisteme të tjera, pa u përshtatur me gjendjet aktuale në shtet dhe me kapacitetet ekzistuese të institucioneve.

Në punën e përditshme të shërbimeve të sigurisë gjithsesi se janë vendosur rregulla të pashkruara ndërsa tendenca për praktikimin e tyre të mëtutjeshëm mund të rezultojë me obstrukcione të kamufluara gjatë zbatimit të akteve të reja normative. Megjithatë, shprehinë nuk ndryshojnë lehtë me mjete normative dhe administrative.

Ligjet reformuese ofruan disa zgjidhje cilësore normative, megjithatë edhe më tutje mbeti diskutabil funksionaliteti i sistemit në tërësi. Edhe në “Raportin e Pribes” u theksua se vetëm disa rekomandime kanë të bëjnë me ndryshimet e domosdoshme të legjislacionit, ndërsa shumica e rekomandimeve mund të realizohen në kuadër të kornizës ekzistuese kushtetuese dhe ligjore. Së këtejmi, zbatimi konsekuent i ligjeve në praktikë është diçka ndaj të cilit duhet të synojnë institucionet. Për këto shkaqe, nuk mund të konsiderojmë se procesi i reformimit ka përfunduar, veçanërisht nëse merren parasysh dobësitë të cilat tanimë evidentohen gjatë implementimit praktik të disa zgjidhjeve ligjore.

Konkretisht, në legjislacionin e reformuar janë lënë disa çështje diskutabile, edhe pse për ato u debatua në diskutimet të cilat i paraprinë miratimit të Ligjit për ndjekje të komunikimeve. Kjo veçanërisht ka të bëjë me dispozitat për ndjekjen e komunikimeve pa ndërmjetësimin e ATO-s me çka në të vërtetë humbet kuptimi i ekzistimit të kësaj Agjencie dhe rrënohet besimi në sistemin e ndjekjes ligjore të komunikimeve. Nga ana tjetër, dispozitat sa u përket meta të dhënave doemos duhet të rishikohen dhe të rregullohen në mënyrë precize, pa dispozita kundërthënëse, të cilat tani janë pjesë të disa ligjeve të ndryshme. Në aspektin nomoteknik, veçanërisht problematike është gama e masave të reja për ndjekjen e komunikimeve në interes të sigurisë dhe mbrojtjes, mundësia ligjore për zbatimin e tyre parandalues dhe zgjerimi i përfshirjes së veprave penale për të cilat mund të ndiqen komunikimet.

Të gjitha këto elemente të veçanta diskutabile megjithatë mund të tejkalohen me një qasje serioze dhe mirëfilli të sinqertë gjatë krijimit të normave ligjore. Së këtejmi, për rregullimin gjithëpërfshirës të fushës së ndjekjes së komunikimeve, si dhe për mbikëqyrjen dhe kontrollin mbi shërbimet e sigurisë, nevojitet planifikim dhe ndërmarrje të masave përkatëse në plan afatgjatë dhe jo vetëm në kuptimin normativ. Duke e pasur parasysh këtë, do të ishte e dobishme në një kontekst më të gjerë të mendohet në këtë drejtim:

- Unifikim në një tekst të vetëm ligjor të segmenteve të cilat tani pa nevojë janë përfshirë edhe në dispozitat e Ligjit për ndjekjen e komunikimeve edhe në dispozitat e Ligjit për procedurë penale, ndërsa disa edhe në Ligjin për ASN. Kjo krijon konfuzion dhe interpretime të ndryshme të çështjes së njëjtë.
- Ndarje të qartë të autorizimeve të shërbimeve të sigurisë, me qëllim që të shmanget mbivendosja e kompetencave dhe mundësia e keqpërdorimit gjatë veprimit. Në këtë mënyrë do të shmangen situatat absurde kur për ngjarje të njëjtë ka informacione të ndryshme ose kur rasti i njëjtë ose personi i njëjtë si kërcënim i sigurisë është objekt observimi ose objekt i punës i më shumë shërbimeve njëkohësisht.
- Krijimi i konceptit të qartë për tejkalimin e problemeve evidente me ndikime politike mbi punën e shërbimeve të sigurisë dhe organeve të jurisprudencës që ndonjë herë në mënyrë dramatike e determinon punën e tyre dhe seriozisht e rrënon objektivitetin dhe profesionalizmin e tyre.
- Krijimi i mekanizmave të cilët do të kontribuojnë në eliminimin e ndikimeve partiake-politike mbi personat e përfshirë në mbikëqyrjen dhe kontrollin mbi ndjekjen e komunikimeve, ngritja e nivelit të kulturës së sigurisë dhe fuqizimi i integritetit dhe besimit midis të gjitha subjekteve relevante.
- Krijimi i zgjidhjeve të qëndrueshme ligjore të cilat korrespondojnë jo vetëm me kapacitetet dhe nevojat e institucioneve, por edhe me realitetin në një kontekst më të gjerë, duke e pasur parasysh kulturën, shprehinë dhe mentalitetin.

## BIBLIOGRAFIA

1. **Ligji për ndjekjen e komunikimeve**, “Gazeta Zyrtare” nr. 71/18, 108/19
2. **Ligji për Agjencinë Teknike Operative**, “Gazeta Zyrtare” nr. 71/18, 98/19
3. **Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për komunikime elektronike**, “Gazeta Zyrtare” nr. 11/18, 98/19
4. **Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurë penale** “Gazeta Zyrtare” nr. 198/18
5. **Ligji për plotësimin e Ligjit për informacione të klasifikuara** “Gazeta Zyrtare” nr. 21/18
6. **Ligji për Agjencinë e Sigurisë Nationale**, “Gazeta Zyrtare” nr. 108/19
7. **Ligji për koordinimin e bashkësisë të sigurisë-zbulimit**, “Gazeta Zyrtare” nr. 108/19
8. **Ligji për procedurë penale**, “Gazeta Zyrtare” nr. 150/10, 09/12, 198/18
9. **Ligji për komunikime elektronike**, “Gazeta Zyrtare” nr. 39/14, 188/14, 44/15, 193/15, 11/18, 21/18, 98/19
10. **Ligji për polici**, “Gazeta Zyrtare” nr. 114/06, 114/06, 6/09, 145/12, 41/14, 33/15, 31/16, 106/16, 120/16, 21/18, 64/18
11. **Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale**, “Gazeta Zyrtare” nr. 42/2020
12. **Zakon o sigurnosno-obavještajnom sustavu Republike Hrvatske, në dispozicion në:** <https://www.uvns.hr/UserDocImages/dokumenti/nacionalna-sigurnost/ZAKON-O-SIGURNOSNO-OBAVJESTAJNOM-SUSTAVU-RH-NN-79-2006.pdf>
13. **The United Nations Convention Against Transnational Organized Crime (2000)**
14. **Directive (EU) 2016/680 of The European Parliament and of The Council of 27 April 2016, on the protection of natural persons with regard to the processing of personal data by competent authorities for the purposes of the prevention, investigation, detection or prosecution of criminal offences or the execution of criminal penalties, and on the free movement of such data**
15. **Council of Europe Recommendation (2005) 10 of the Committee of Ministers to member states on “special investigative techniques” in relation to serious crimes including acts of terrorism**
16. **Council of Europe Recommendation (2001) 11 of the Committee of Ministers to member states concerning guiding principles of the fight against organized crime**
17. **EUROPEAN COMMISSION Neighborhood and Enlargement Negotiations Urgent Reform Priorities for the Former Yugoslav Republic of Macedonia** [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news\\_corner/news/news-files/20150619\\_urgent\\_reform\\_priorities.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_urgent_reform_priorities.pdf)

18. **The Former Yugoslav Republic of Macedonia: Assessment and recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues 2017, Brussels, 14 September 2017** [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14\\_seg\\_report\\_on\\_systemic\\_rol\\_issues\\_for\\_publication.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf)
19. **European Commission for Democracy through Law (Venice Commission) Rule of Law Checklist, March 2016, në dispozicion në:** [https://www.venice.coe.int/images/SITE%20IMAGES/Publications/Rule\\_of\\_Law\\_Check\\_List.pdf](https://www.venice.coe.int/images/SITE%20IMAGES/Publications/Rule_of_Law_Check_List.pdf)
20. **Përfaqësues të Kuvendit në vizitë tek ATO, 19.07.2019, i aksesshëm në:** <https://ota.mk/mk/190719-pretstavnic-i-sobranie-poseta-ota>
21. **Raporti vjetor për punën e Agjencisë Teknike Operative Shkup, për vitin 2018, i aksesshëm në:** <https://ota.mk/adocs/scan-izvestaj-ota-2018.pdf>
22. **Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, mbledhja e 45-të e mbajtur më datë 22.04.2020, e aksesshme në:** <https://vlada.mk/vladini-sednici>



**DCAF** Qendra e Gjenezës  
për Qeverisjen e  
Sektorit të Sigurisë

P.O.Box 1360  
CH-1211 Geneva 1 Switzerland

✉ [info@dcaf.ch](mailto:info@dcaf.ch)

☎ +41 (0) 22 730 9400

---

**[www.dcaf.ch](http://www.dcaf.ch)**

---

🐦 [@DCAF\\_Geneva](https://twitter.com/DCAF_Geneva)